

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË-TIRANË
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I INFERMIERISTIKËS**

DISERTACION

I

PARAQITUR NGA

Znj. FLORA ZYBERAJ

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE

DOKTOR

NË

SHKENCA INFERMIERORE

**TEMA: “PREVALENCA E ÇRREGULLIMEVE TË ANKTHIT NË
STUDENTË E UNIVERSITETIT MJEKËSISË TIRANË”**

Udhëheqës Shkencor: Prof. Ass. ARIEL ÇOMO

Tiranë, 2016



UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

DISERTACION

I

PARAQITUR

NGA

ZNJ. FLORA ZYBERAJ

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE

“ DOKTOR

NË

SHKENCA INFERMIERORE”

**TEMA: “PREVALENCA E ÇRREGULLIMEVE TË ANKTHIT NË
STUDENTËT E UNIVERSITETIT MJEKËSISË TIRANË”**

MBROHET MË DATË...../.....2016 PËRPARA JURISË

1. _____ **KRYETAR**
2. _____ **ANËTAR (OPONENT)**
3. _____ **ANËTAR (OPONENT)**
4. _____ **ANËTAR**
5. _____ **ANËTAR**

Deklaratë

Punimi i kësaj teme është origjinale. Vetëm një pjesë e të dhënave statistikore është përdorur për të përmbushur detyrimet e doktoraturës.

Ky punim i plotë nuk është paraqitur asnjëherë si brenda dhe jashtë vendit.

© Flora ZYBERAJ 2016

Abstrakti

Hyrje. Çrregullimet e ankthit janë gjendje që karakterizohen nga simptoma fizike dhe psikike të dallueshme dhe persistente të cilat nuk janë pasojë e një çrregullimi tjetër. Simptomatika mund të jetë permanente si një çrregullim i përgjithshëm i ankthit ose të tipit episodik. Studentët janë një popullatë vulnerable për të manifestuar simptoma apo çrregullime të ankthit të cilat mund të ndikojnë në cilësinë e jetës apo në performancën akademike.

Qëllimi. Të përcaktohet prevalenca e çrregullimeve të ankthit në studentët e Universitetit Mjekësisë Tiranë, specifikisht çrregullimi i ankthit të përgjithshëm dhe çrregullimi i panikut si edhe të gjendet korrelacioni midis ankthit dhe përdorimit të substancave (alkoolit).

Materiali dhe Metoda. Ky është studim epidemiologjik cross sectional realizuar në dy periudha kohore përgjatë viteve 2013-2014 (në muajt Tetor-Nëntor-Dhjetor 2013 dhe Mars-Prill-Maj të 2014) me pjesëmarrjen fillestare të 1550 studentëve të pesë fakulteteve të Universitetit të Mjekësisë (përkatesisht të Fakultetit të Mjekësisë së Përgjithshme, Fakulteti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Fakulteti i Shëndetit Publik). Në fazën e dytë kampioni ka rezultuar të jetë 1282 që iu krye vlerësimi i ankthit dhe vlerësimi psikiatrik për ata që rezultuan me nivele të larta të ankthit. Analiza statistikore u krye duke përdorur SPSS 15.0.

Rezultatet: Prevalenca e çrregullimeve të ankthit në studentët e Universitetit të Mjekësisë në Tiranë rezultoi të jetë: për çrregullimin e ankthit të gjeneralizuar në 6 muaj është 14.2%, për simptomat e atakut të panikut në 1 muaj 3.9%. Nga totali i studentëve rezulton se 21.3 % e tyre kanë simptoma ankthi në një nivel të moderuar ndërsa 15.1% simptoma ankthi në një nivel të rëndë. Rezultatet e analizës regressive nxorën në pah se konsumi i alkoolit është një prediktor i mirë i ankthit në studentët e kampionit tonë.

Konkluzione. Prej këtij studimi rezulton se shumica e studentëve përjetojnë probleme të lidhura me ankthin dhe ata mund të pësojnë rënie drastike në mbarvajtjen akademike, dëmtim në performancën praktike e deri në ndërprerje të studimeve gjë që është alarmante. Ndaj rekomandohet ndërhyrje të menjëhershme si për të adresuar problemin shëndetësor por edhe për të rikonceptuar kurikulat shkollore.

Fjalët kyçe: ankthi, student të mjekësisë, çrregullim ankthi

Abstract.

Introduction: Anxiety disorders have distinct and persistent physical and psychological symptoms which are not explained by the existence of another disorder. The symptoms can be permanent as in generalized anxiety disorder or episodic. The students are considered a vulnerable group in risk for having anxiety symptoms or anxiety disorders which on the other hand can affect the quality of their life and academic performance.

Aim. The study is designed to find out the prevalence of anxiety disorders both generalized anxiety disorder and panic disorder in students of University of Medicine in Tirana, and to search out any correlation between anxiety and usage of substances (alcohol).

Material and Methods. It is an epidemiological cross-sectional study completed in two periods of time during 2013-2014. During the first phase (October-November-December 2013) were interviewed 1550 students from five faculties of Medical University of Tirana: Faculty of Medicine, Faculty of Pharmacy, Faculty of Dental Medicine, Faculty of Technical Sciences, and Faculty of Public Health. During the second phase after application of acceptance and exclusion criteria the total number of population in study resulted in 1282 students. Back Anxiety Inventory was the screening tool used to evaluate the level of anxiety of students followed by a psychiatric evaluation by the psychiatrist for those students that showed high anxiety levels. Statistical analysis was performed using the SPSS 15 version.

Results. The prevalence of anxiety disorders between students of University of Medicine in Tirana results in 14.2% in generalized anxiety disorder during 6 months and 3.9% in symptoms of panic attack during 1 month. In general from the total number of students 21.3% of them have moderated levels of anxiety symptoms and 15.1% have high levels of anxiety symptoms. The results of regression analysis have revealed that alcohol use is a good predictor of anxiety levels between students of this population in study.

Conclusions. It resulted that majority of students experience some levels of anxiety and this can have an impact in academic performance even school drop outs which is an alarming fact. It is recommended to offer an immediate intervention to address this mental health issue as well as to raise the awareness of medical university curricula improvement.

Key words: anxiety, medical university students, anxiety disorders

PËRMBAJTJA	
I.PARATHËNIE.....	A
II.MIRËNJOHJE.....	B
1.HYRJE.....	X
1.1 Ç'është ankthi?.....	X
1.2. Shkaqet dhe faktorët e riskut.....	XI
1.3. Klasifikimi i çrregullimeve të ankthit.....	XI
1.4. Simptomat e ankthit.....	XI
1.5. Të dhëna të tjera epidemiologjike.....	XII
1.6. Çrregullimi i panikut me ose pa agorafobi.....	XII
1.6.1. Faktorët predispozues dhe precipitues.....	XIII
1.6.2. Ataku i panikut.....	XIV
1.6.3. Diagnoza e atakut të panikut.....	XIV
1.6.4 Pasojat e çrregullimit të panikut.....	XV
1.6.5. Tipet e atakut të panikut.....	XV
1.6.6.Faktorët precipitues të panikut.....	XV
1.6.7.Sa frekuent është çrregullimi i Panikut.....	XVI
1.7.Fobia Specifike.....	XVII
1.7.1.Fobia shoqerore.....	XVII
1.8.Çrregullimi obsesiv – kompulsiv.....	XVII
1.9.Çrregullimi i ankthit të përgjithshur.....	XVIII
1.9.1.Diagnoza diferenciale e GAD me sëmundje të tjera.....	XIX
1.10.Vlersimi i riskut për suicid dhe i veprimeve vetdëmtuese.....	XIX
1.10.1.Vlerwsimi i ashpërsisë.....	XIX
1.11.Diagnoza diferenciale e ankthit me sëmundje të tjera.....	XX
1.12.Çrregullimi i stresit të posttraumës (PTSD).....	XX
1.13.Çrregullimi i stresit akut.....	XXI
1.14.Çrregullimi I përshtatjes.....	XXII
1.15.Vlerësimi I variablave psikologjik.....	XXII
1.16. Vlerësimi I çeshtjeve kulturore.....	XXIII
1.4.1.Diagnoza diferenciale e çrregullimeve të ankthit.....	XXIII
1.4.2.Diagnoza diferenciale me sëmundje të tjera.....	XXIII
1.4.3.Cilat janë sëmundjet njerzore që mund të shkaktojnë ankth.....	XXIII
1.4.4.Vlerësimi I ashpërsisë së ankthit.....	XXIV
1.6.8.Përmbledhja e procesit të vlerësimit,dhe trajtimi fillestar.....	XXIV
1.6.9.Gjetja e ndryshimeve të përshtatshme në stilin e jetesës.....	XXIV
1.17.Përfshirja e sherbimeve të shëndetit mendor.....	XXV
1.18.Informacion I përgjithshëm rreth Inventarit të Beckut për Ankthin.....	XXVI
2.QËLLIMI I STUDIMIT.....	1
3.MATERIALI DHE METODA.....	3
3.1 Lloji i studimit.....	2

3.2 Periudha kohore e studimit.....	2
3.3 Karakteristikat e kampionit	2
3.4 Kriteret përfshirëse	2
3.5 Kriteret përjashtuese	2
3.6 Përzgjedhja e kampionit.....	2
3.7 Proçesi i anketimit.....	2
3.8.Administrimi.Pikëzimi, dhe Interpretimi	3
3.9.Analiza statistikore e të dhënave.....	4
4. REZULTATE DHE DISKUTIME.....	5
5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	34
8. BIBLIOGRAFIA.....	35
9. ANEKS.....	44

Lista e ilustrimeve dhe e tabelave.

Lista e tabelave.	
<i>Tabela 4.1/A. Shpërndarja e popullatës në studim sipas Moshës.</i>	5
<i>Tabela 4.A/1. Shpërndarja e popullatës në studim sipas gjinisë dhe vendbanimit</i>	6
<i>Tabela 4.A/1.1. Shpërndarja e popullatës në studim sipas vendbanimit.</i>	6
<i>Tabela 4.A/2 Shpërndarja e kampionit sipas fakulteteve</i>	6
<i>Tabela4. 1. Shpërndarja e popullatës në studim sipas moshës</i>	7
<i>Tabela 4.1.1 Përqindja e popullatës në studim sipas moshës</i>	7
<i>Tabela4. 2. Shpërndarja e popullatës në studim sipas Gjinisë</i>	8
<i>Tabela4. 3. Shpërndarja e popullatës në studim sipas vendbanimit</i>	8
<i>Tabela 4.4 .Shpërndarja e subjekteve sipas vitit akademik</i>	8
<i>Tabela 4.5 .Shpërndarja e popullatës në studim sipas gjendjes civile</i>	9
<i>Tabela.4.6 . Shpërndarja sipas nivelit ekonomik (të ardhurat mujore familjare)</i>	10
<i>Tabela 4.7 .Shpërndarja e konsumit të duhanit në popullatën në studim</i>	11
<i>Tabela 4.8 .Shpërndarja e konsumit të duhanit sipas numrit cigareve/dite në popullatën në studim</i>	11
<i>Tabela4.9. Shpërndarja e konsumit të kafesë në popullatën në studim</i>	12
<i>Tabela 4.10. Shpërndarja e konsumit të alkolit në popullatën në studim</i>	12
<i>Tabela 4.11. Shpërndarja e konsumit të alkolit në popullatën në studim</i>	12
<i>Tabela4. 12. Shpërndarja e konsumit të pijeve energjike në popullatën në studim</i>	13
<i>Tabela 4.13. Shpërndarja hereditetit familjar për sëmundje mendore në popullatën në studim</i>	13
<i>Tabela 4.14. Shpërndarja sëmundjeve tiroidiene në familjet e popullats në studim</i>	14
<i>Tabela4. 15. Shpërndarja sëmundjeve kronike në familjet e popullats në studim</i>	14
<i>Tabela 4.16. Prania e simptomës “Mpirje/ndjesi shpimi”</i>	15
<i>Tabela 4.17. Prania e simptomës “Ndjesi të nxehti në trup”</i>	15
<i>Tabela 4.18. Prania e simptomës “Ndjesi dridhjeje në trup”</i>	16
<i>Tabela 4.19. Prania e simptomës “Pamundësi për t’u rehatuar”</i>	16
<i>Tabela 4.20. Prania e simptomës “Frikë se mund të ndodhë më e keqja”</i>	16
<i>Tabela 4.21. Prania e simptomës “Marrje mendsh/ndjenjë boshllëku në kokë”</i>	16
<i>Tabela 4.22. Prania e simptomës “Rrahje të shpejta të zemrës”</i>	17

Tabela 4.23. Prania e simptomës “Mungëse qetësie”	17
Tabela 4.24. Prania e simptomës “Ndjesi tmerri”	17
Tabela 4.25. Prania e simptomës “Nervozizëm/irritim”	18
Tabela 4.26. Prania e simptomës “Ndjesi mbytjeje/lëmsh grykë”	18
Tabela 4.27. Prania e simptomës “Dridhje duarsh”	18
Tabela 4.28. Prania e simptomës “Ndjesi korrenti në trup”	18
Tabela 4.29. Prania e simptomës “Frikë e humbjes kontrollit”	18
Tabela 4.30. Prania e simptomës “Vështirësi në frymëmarrje”	19
Tabela 4.31. Prania e simptomës “Frikë se vdes”	19
Tabela 4.32. Prania e simptomës “Ndjesi lemerie/alarmi”	19
Tabela 4.33. Prania e simptomës “Fryrje/parehati në bark”	19
Tabela 4.34. Prania e simptomës “Ndjesi të fikti”	20
Tabela 4.35. Prania e simptomës “Skujje në fytyrë”	20
Tabela 4.36. Prania e simptomës “Djersitje jo prej të nxehtit/vapës”	20
Tabela 4.37. Diferenca gjinore analizuar me metodën ANOVA	21
Tabela 4.38. Frekuenca e nivelit të ankthit në gjithë popullatën në studim	21
Tabela 4.B/1. Shpërndarja e popullatës në studim sipas Fakulteteve	23
Tabela 4.39. Frekuenca e nivelit të ankthit në gjithë popullatën në studim	24
Tabela 4.40. Paraqet rezultatet statistikore për nivelin e ankthit sipas fakulteteve	26
Tabela 4.41. Përmbledhja e testit të Hipotezës Zero dhe vlerat e testit Kruskal Wallis	27
Tabela 4.42. Analiza krahasuese e nivelit të ankthit midis Fakulteteve sipas Testit Pairwise	28
Tabela 4.43. Paraqet rezultatet statistikore për nivelin e ankthit sipas viteve akademike	29
Tabela 4.44. Përmbledhja e testit të Hipotezës Zero dhe vlerat e testit Kruskal Wallis	31
Tabela 4.45. Analiza krahasuese e nivelit të ankthit midis tre viteve akademike sipas Testit Pairwise	31
Tabela 4.46. Niveli i ankthit dhe përdorimi i alkolit	32
Tabela 4.47. Niveli i ankthit dhe përdorimi i alkolit sipas ANOVA	32
Tabela 4.48. Niveli i ankthit dhe përdorimi i alkolit sipas regresionit	32
Tabela 4.49. Niveli i ankthit dhe përdorimi i alkolit sipas regresioni	33
Listave Grafikëve	
Grafiku.4. 1. Shpërndarja e popullatës në studim sipas Fakulteteve	6
Grafiku.4.2. Shpërndarja e popullatës në studim sipas Gjinisë	
Grafiku 4.3. Shpërndarja e popullatës në studim sipas vitit akademik	7
Grafiku 4.4. Shpërndarja e popullatës në studim sipas gjendjes civile	8
Grafiku 4.5. Shpërndarja e nivelit arsimor të prindërve për popullatën në studim	9
Grafiku.4.6. Shpërndarja sipas nivelit ekonomik (të ardhurat mujore familjare)	10
Grafiku 4.7. Shpërndarja e konsumit të duhanit në popullatën në studim	10
Grafiku 4.8. Shpërndarja e konsumit të kafesë në popullatën në studim	11
Grafiku 4.9. Shpërndarja e konsumit të alkolit në popullatën në studim	12
Grafiku 4.10. Shpërndarja hereditetit familjar për sëmundje mendore në popullatën në studim	13
Grafiku 4.11 Shpërndarja sëmundjeve tiroidiene në familjet e popullats në studim	14
Grafiku 4.12. Shpërndarja sëmundjeve kronike në familjet e popullats në studim	14
Grafiku 4.13. Shpërndarja sëmundjeve kronike në popullatën në studim	15
Grafiku 4.14. Përqindja e nivelit të ankthit në gjithë popullatën në studim	21
Grafiku.4. 15. Niveli i ankthit të matur nga BAI sipas gjinisë (ANOVA)	22
Grafiku.4 .16. Simptomat e panikut në studentët e kampionit tone	24
Grafiku 4.17. Shpërndarja e simptomave të ankthit të gjeneralizuar në kampionin tone	24
Grafiku 4.18. Prevalenca e Ankthit në popullatën në Studim	25
Grafiku 4.19. Prevalenca e simptomave të GAD në popullatën në studim	26

Grafiku 4.20. Paraqet rezultatet statistikore për nivelin e ankthit sipas fakulteteve	27
Grafiku 4.21. Paraqet rezultatet statistikore për nivelin e ankthit sipas viteve bazuar në medianën	30
Grafiku 4.22. Paraqet rezultatet statistikore për nivelin e ankthit sipas viteve bazuar në mesatare	31
Ilustrimet	
Figura. 4.1 Grafiku i diferencës së mesatareve	21
Figura.4.2. Niveli i ankthit në bazë të “Testit Pairwise”ndërmjet 5 fakultetve	27
Figura .4.3. Lidhja mes nivlit tësimptomave të ankthit dhe konsumimit të alkoolit	33

1. PARATHËNIE

Çrregullimet e ankthit janë një grup gjendjesh që kanë të përbashkët një tipar kyç, ankthin e shtuar të shoqëruar me përgjigje biheviorale, emocionale dhe fiziologjike. Personat të cilët vuajnë nga çrregullimet mund të demonstrojnë, sjellje të pazakonshme, si panik pa asnjë arsye, frikë të pajustificuar ndaj objekteve ose situatave jetësore, veprime të pakontrolluara, ripërjetime të ngjarjeve traumatike, ose shqetësim i pashpjegueshëm. Ata përjetojnë shqetësim domethënës dhe me kalimin e kohës, çrregullimi dëmton në mënyrë të spikatur, rutinën e përditshme, jetën sociale dhe funksionimin okupacional.

Duke e parë në këtë këndvështrim, zgjedha gjetjen e çrregullimeve të ankthit për faktin se ende ka pak studime të mirëfillta përsa i takon këtyrë çrregullimeve në një popullatë mjaft të ndjeshme sikundër janë studentët, veçanërisht studentët e mjekësisë. Duke studiuar çrregullimet e ankthit, të cilat janë disa lloje kam zgjedhur dy nga format e çrregullimeve të ankthit të tillë si çrregullimin e panikut dhe çrregullimin e ankthit të përgjithshuar, për faktin se janë dy çrregullime shumë frekvente sidomos për moshat e reja, moshë e cila është edhe kampioni ynë. Gjetja e çrregullimeve të ankthit në një grup popullate siç janë studentët e universitetit mjekësisë, e konsideroj domethënëse për arsyen e specifikave që ka popullata e marrë në studim dhe implikimi që shkaktojnë këto çrregullime në performancën akademike, apo në riskun për të përdorur substanca të ndryshme me qëllim qetësimin e simptomave të ankthit. Në praktikën tonë të përditshme, të punës, me studentët ne përballlemi shumë shpesh me raste të tilla, por në literaturë nuk ekzistojnë të dhëna të plota në lidhje me çrregullimet e ankthit në grupin e studentëve në përgjithsi në vendin tonë. Gjetja e çrregullimeve të ankthit në studentët mendoj që do të gjeneorjë mundësi për ndërmarjen e objektivave konkrete në këtë drejtim në mënyrë që të ndërhyhet sa më parë për të ofruar kujdes të veçantë nga klinikistët, psikiatër apo psikologë apo kontribues të tjerë të shëndetit mendor. Të gjitha rezultatet e marra nga ky studim shpresoj të bëhen pjesë e programeve parandaluese për përmirësimin e shëndetit psiko – social të studentëve jo vetëm të fakulteteve të Univeristetit të Mjekësisë por edhe të fakulteteve të tjera.

II. FALENDERIME

Kjo është pjesa më e bukur, por edhe pak e vështirë, sepse dëshiroj të falenderoj të gjithë bashkëpunëtorët të cilët më kanë mbështetur në këtë studim.

Personi i parë që dëshiroj ta falenderoj, me shumë respekt dhe mirënjohje është Prof.Dr.Petrit Bara i cili vazhdimisht na inkurajon dhe na mbështet në mënyrë të vazhdueshme në rritjen tonë akademike, pa ndihmën e të cilit nuk do të kishim mundësi për të realizuar një studim të këtij formati.

Dua të falenderoj njëkohësisht me shumë mirënjohje dhe respekt udhëheqësin shkencor, Prof.Ass. Ariel Çomo për ndihmën dhe mbështetjen gjatë gjithë etapave të studimit.

Gjithashtu një tjetër falenderim ia dedikoj Prof.Dr. Elizana Petrela për punën e bërë në përpunimin statistikor të të dhënave të këtij studimi.

Gjithashtu pjesë e rëndësishme e studimit tonë janë bërë edhe mjekët psikiatër F. Elezi; A. Braho; E. Sotiri. Falë profesionalizmit dhe gadishmërisë së tyre u arrit kompletimi dhe përmbyllja e studimit, për shkak se pas zbulimit të simptomave të ankthit ishte diagnostikimi i studentëve të përfshirë në studim.

Po ashtu u jam shumë mirënjohëse dhe i falenderoj përzemërsisht kolegët e mi pedagog, në të gjitha fakultetet pjesëmarrëse në studim. Së fundi, por jo për nga rëndësia të gjithë kolegët e fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, të cilët më kanë ndihmuar në shpërndarjen e pyetësorit në studentët e këtyre fakulteteve.

Në fund falenderimi i shkon familjes time e cila më ka mbështetur vazhdimisht dhe njëkohësisht ju kërkoj ndjesë fëmijëve të mi, ku shpesh më është dashur edhe të sakrifikoj nga koha dedikuar atyre.

1.HYRJE

Çrregullimet e ankthit janë gjendje që karakterizohen nga simptoma fizike dhe psikike të dallueshme dhe persistente të cilat nuk janë pasojë e një çrregullimi tjetër. Simptomatika mund të jetë permanente si një çrregullim i gjeneralizuar i ankthit ose të tipit episodik.

Ka edhe një tjetër kategorizim, kur ankthi shfaqet pas një situatë konkrete frikësuese i quajtur - çrregullim fobik i ankthit; ndërsa, kur ankthi shfaqet në çfarëdo situatë quhet-çrregullim paniku. Çrregullimi fobik i ankthit klasifikohet: fobi e thjeshtë, fobi sociale, agorafobia, çrregullimi i panikut me ose pa agorafobi, agorafobia pa anamnezë të çrregullimit të panikut.

Çrregullimi i ankthit të gjeneralizuar takohet 50/1000 të popullatës së përgjithshme; agorafobitë në 30/1000; fobia sociale 25/1000; fobia specifike në 100/1000; çrregullimi i panikut në 15/1000; çrregullimi obsesiv-kompulsiv në 15/1000 psikiatrike. Fobitë specifike janë më të zakonshme, por shpesh njerëzit me këto çrregullime nuk kërkojnë mjekim.

1.1 Ç'është ankthi?

Ankthi është një gjendje emocionale normale dhe e paevitueshme, si pjesë e jetës së përditshme. Çdonjëri në një moment të caktuar të jetës së tij do të provojë ndjenjën e frikës, “stresit të shprehur”, ose nervozizëm e humbje kontrolli. Në mjaft situata këto janë reagime normale, pra ankthi është një reaksion, përgjigje normale dhe e shëndetshme në përballjen me situatat e rrezikshme dhe kërcënuese.

Ankthi është një term “ombrellë” për ndryshimet fizike, mendore dhe të sjelljes, të cilat shfaqen automatikisht për përballimin e kanosjes.

Individët mund të ndjehen të kërcënuar e për rrjedhojë shfaqin shqetësim e nervozizëm. Gjithashtu, ata kanë vështirësi për t'u përqëndruar në çdo gjë tjetër, përveçse në situatën kërcënuese. Sinjalet e trurit të tyre çlirojnë hormone, të cilat nxisin aktivizimin e sistemit nervor simpatik dhe ajo çfarë është e zakonshme referohet si përgjigje “lufto –ose-vrapo” “fight-or-flight”.

Kjo përgjigje gjeneron energjitë fizike për të luftuar ose për t'u larguar prej kërcënimit:

- Rritje të qarkullimit të gjakut (të aftësisë koaguluese), përgatitje për një dëmtim të mundshëm
- Rritje e shpëjtësisë së ritmit të zemrës dhe të presionit të gjakut
- Shtim të djersitjes për të ndihmuar ftohtësinë trupore
- Shtim i qarkullimit kryesisht në muskuj, të cilët janë të gatshëm për të vepruar për mbrojtje
- Ngadalësim të tretjes
- Pakësim të prodhimit të pështymës, duke shkaktuar tharje goje
- Shtim i ritmit të frymëmarrjes
- Rritje e çlirimit të sheqerit për të shtuar prodhimin e energjive
- Shtim i urinimit dhe/ose e lëvizshmërisë së zorrëve (shfaqet me diare)
- Dobësim i përgjigjeve imune (e nevojshme për një periudhë të shkurtër kohe për të lejuar përgjigje më të plotë ndaj një kërcënimi të papritur, por, ka me shumë të ngjarë që dëmtimi të vazhdojë për një kohë të gjatë).

Por përgjigja e menjëhershme “lufto –ose-largohu”, jo gjithmonë është mënyra më e mirë për t'u përballur me një situatë kërcënuese, por kërcënimet në shoqërinë njerëzore (p.sh, oshilacionet e zhvillimit social) janë shpesh mjaft të zgjatura dhe ndonjëherë përtej fuqisë së individit për t'i zgjidhur ato dhe mund të përfundojë në një ankth kronik.

1.2 Shkaqet dhe Faktorët e riskut

Çrregullimet e ankthit zakonisht shkaktohen ose janë rrejdhojë e ndërthurjes së disa faktorëve duke përfshirë:

- a. Faktorët gjenetikë
- b. Hereditetin familjar
- c. Faktorët më të fundit stresantë
- d. Kushtet jetësore
- e. Besimet dhe qëndrimet personale
- f. Aftësinë për të shprehur ndjenjat

Të dhënat sugjerojnë se pavarësisht llojeve të çrregullimeve mendore, një pjesë e mirë e tyre ndajnë të njëjtët faktorë risku.

1.3. Klasifikimi i çrregullimeve të ankthit

Në çrregullimet e ankthit sipas klasifikimit të DSM–IV përfshihen:

- fobia specifike,
- fobia sociale,
- çrregullimi obsesivo-kompulsiv,
- PTSD (çrregullimi i stresit të pas traumës),
- çrregullimi i stresit akut,
- çrregullimi i ankthit të gjeneralizuar,
- çrregullimet e përshtatjes,
- çrregullime ankthi si pasojë e marrjes së një substance apo të një sëmundje të përgjithshme.

1.4.Simptomat e Ankthit

- Duke pritë për më të keqen dhe me mërzitje të tepruar
- Shmangie e situatave të frikshme
- Pamundësia për të shpjeguar ankesat somatike si p.sh të rrahurat e shpejta të zemrës,dhembje koke, zbehtësia, marrje mendësh.
- Frymarrje të shpejtuar
- Dridhje muskulare,veçanarrisht në shpatulla,qafë, dhe nofull
- Ndjehet lehtësisht tronditur
- Depersonalizim(ikje nga personi vet, ikja nga vetvetja)
- Derealizimi (pamundësia e realizimit të ëndërrës tij.)
- Të menduarit e keq si p.sh bota është një vend i keq dhe diçka e keqe ka për të ndodhur
- Zakoni i zvoglimit ankthit

Hetimi brendshëm zhvillimit të këtyre simptomave duhet të mbulojë:

- natyrën e tyre , shpeshtësinë ,ataket e përditshme të panikut dhe shpeshtësinë e tyre.
- përqindja e fillimit të tyre, gradual ose e shpejtë , ose si rezultat i një tronditje si në PTSD ose në reagimin akut të stresit

Zgjatja e simptomave jonormale të reagimit të stresit si p.sh brenga ose veprimi akut i stresit.Gjithsecili mund të ketë zgjatje të simptomave të mundshme te cilat flasin për mundësinë e çrregullimeve të përshtatjes.

Ngjarjet aktuale të fundit dhe mungesa e mbështetjes sociale- ku stresi nuk duhet të jetë përdorur në shpjegimin e çrregullimeve të ankthit , por stresi disa here mund të kthehet në çrregullimet e ankthit.

Duke stimuluar stiuatat, ose duke keqsuar simptomat, duke përfshirë edhe frikën sa herë që ajo shfaqet dhe është e pranishme në jetën e njerzve.

-sa i madh është ankthi që shfaqet në parashikimine kësaj situatë.

-personat me ngritje nivelit të shfaqjes së shenjave të sistemit autonom, ku parashikimi i frikës të shfaqur në fytyrë ,në objektet dhe në situatat e frikshme.

-sa e madhe të jetë përfshirja e të tjeve, familjarëve në këto situata, aq më e madhe është mundësia e paksimit të çrregullimeve personale të ankthit.

-historia e çrregullimeve të ankthit mund të përfshijë edhe ankthin e fëmijërisë.

Mund të përfshijë edhe historinë familjare të çrregullimeve të ankthit, sëmundjet e rënda fizike apo edhe abuzimi me substancat e dëmshme ,ndonjëherë edhe tërheqja prej tyre.

Disa çrregullime të ankthit mund të jenë edhe kronike, dhe personi mund të ketë shenja të këtij çrregullimi për disa vite me rradhë përpara kërkimit të ndihmës. Njerzit kujdesen që të krijojnë jetën e tyre duke shmangur në maksimum faktorët stresues të jetës së tyre, dhe sjelljet ankstoze, të cilat shumë shpesh mund të shkaktojnë mbylljen e këtyre njerzve në vetvete.

1.5. Të dhëna të tjera epidemiologjike

Prevalenca për 12-muaj dhe prevalenca e jetës së çrregullimit të panikut në popullatën e SHBA (prek moshat 15 - 54 vjeç) ishte 2.7 % dhe 4.7 %, respektivisht, rezultat i nxjerrë nga një studim kombëtar (2005). Një rishikim sistematik i 13 studimeve europiane raportojnë një shifër prevalence të 12 muajve të çrregullimit të panikut në 1.8 %.

Prevalenca e çrregullimit të panikut në pacientët e kujdesit primar është afërsisht dy herë më e lartë se në popullatën e përgjithshme më shifër 4 – 8 %. Ataket e panikut (të cilat mund të shfaqen edhe në çrregullime të tjera, përveç çrregullimit të panikut) janë shumë më të shpeshta se çrregullimi i panikut, me shfaqje 1 në 3 persona kanë një atak paniku në një moment të caktuar të jetës së tyre.

Përrjashtimi e sëmundjeve somatike dhe çrregullimeve të tjera psikiatrike, ndihmon konfirmimin i diagnozës së çrregullimit të panikut nëpërmjet me një ekzaminim të thjeshtë skrinues të statusit mendor dhe fillimit të një trajtimi të përshtatshëm. Referimet janë efektive në kohë dhe ulin shpenzime për pacientët me këtë gjëndje, të cilët kanë përqindje të lartë shërbimesh mjeksore.

1.6. Çrregullimi i panikut (me ose pa agorafobi)

Çrregullimi panikut karakterizohet nga episode të papritura të një frike të menjëhershme që shfaqet pa ndonjë shkak të dukshëm.

Ndjenjat e panikut, zakonisht zgjasin vetëm 5-10 minuta, por mund të oshilojnë për një periudhë deri në dy orë.

Ataku i panikut

Simptomat kryesore të këtij çrregullimi janë shenjat e ankthit të shfaqura papritmas dhe rritja dramatike dhe spontane e frikës për përfundim katastrofik.

Ekzistojnë tri hipoteza rreth shkaqeve të çrregullimit të panikut. Hipoteza e parë është çrregullimi biokimik, e dyta hiperventilimi dhe e treta është anormaliteti konjitiv ose njohës. Por më shumë të ngjarë ka kombinimi i shkakut të parë me atë të fundit.

Çrregullimi i panikut diagnostikohet vetëm atëherë kur ataket e panikut janë të përsëritura dhe të papritura, ndërkohë që i sëmuri ka frikën e vazhdueshme se mos i ndodh një tjetër atak të paktën për një muaj. Ky çrregullim zgjat disa javë ose muaj dhe mund të

bëhet kronik. Njerëzit që vuajnë nga ky çrregullim, zakonisht shfaqin midis atakeve nervozizëm dhe shqetësim.

Shpesh çrregullimi i panikut pasohet nga shfaqja e agorafobisë. Ky çrregullim takohet më tepër në femra se tek meshkuj dhe fillon në fund të adoleshencës ose në moshën e pjekurisë së hershme, por mund të fillojë edhe më vonë në dekadën e katërt ose të pestë të jetës.

Prevalenca e çrregullimit të panikut në popullatën e përgjithshme.

Frekuenca dhe konsistenca në rritje e studimeve epidemiologjike, në kërkimet e çrregullimit të panikut, ka vlerësuar grupe të ndryshme populatë (kultura, raca, grupime shoqërore [Wittchen, 1993]). Studimet e kryera në komunitet vlerësojnë se në një periudhë të caktuar, në çdo muaj të dhënë, referohet 0,5% e popullatës mund të diagnostikohen me çrregullim paniku [Katon 1989], ndërsa në studimet botërore është referuar një prevalencë për gjatë jetës, në vlerat ndërmjet 1,5% dhe 3,5% [DSM-IV, 1994]. Në studimet epidemiologjike të zonave të mbulimit në SHBA (të ngjashme me qendrat komunitare të Shëndetit Mendor – QKSHM në Tiranë) raportohen vlerat e prevalencës së çrregullimit të panikut deri në 9% të popullatës, do të kenë paktën një atak paniku gjatë jetës së tyre, dhe më shumë se 3%, do të kenë atake paniku rekurente [Klerman 1990].

Mosha e fillimit

Të dhënat e nxjerra nga rishikimet e literaturës, në lidhje me moshën e fillimit të çrregullimit të panikut tregojnë variante të ndryshme, por mesataret janë të qëndrueshme. Fillimi më i zakonshëm është raportuar në moshën 20 – 35 vjeç [Wittchen 1993]. Disa studime janë bërë për moshën e fillimit të atakut të parë, disa të tjera për fillimin e çrregullimit të panikut.

Në një numër të vogël rastesh mund të ketë fillim në fëmijëri, dhe fillim i vonshëm kur shfaqet mbi moshën 45 vjeç.

1.6.1. Faktorët predispozues dhe precipitues

Faktorët e mundshëm predispozues për një individ me çrregullim paniku janë:

- Predispozita gjenetike
- Sëmundjet fizike, shkaktojnë anormalitete persistente neurokimike (hipertiroidizmi), ose krijojnë frikëra të vazhdueshme, të një katastrofë afërt (prolaps i valvulës mitrale).
- Traumata e zhvillimit, në mënyrë të vecantë rrisin vulnerabilitetin.
- Përvojat e papërshtatshme personale, ose identifikimi, për të krijuar mekanizma të përshtatshme përballuese.
- Modelet konjiktive joproduktive, objektiva joreale, vlera të paarsyeshme, ose “kopjim i modeleve të papërshtatshme të të tjerëve” [Beck, 1985]

Ka edhe disa faktorë të tjerë që mund të shtohen në listën e mësipërme, të cilat shkaktojnë drejtpërdrejt ose jo simptoma paniku.

- Sëmundjet fizike dhe substancat toksike
- Stresorë të jashtëm të rëndë (p.sh ekspozimi ndaj rrezikut psikologjik dhe fizik)
- Stresorë të jashtëm kronik
- Stresi specifik i jashtëm, mund të nxisë vulnerabilitetin emocional (p.sh një disiplinë e rreptë në ushtri që perk autonominë e personit). Megjithatë mund të thuhet se çrregullimi i panikut, shkaktohet nga faktorë mjaft kompleks [Beck, 1985]

Çrregullimi i panikut karakterizohet nga episode të papritura të një frike të menjëhershme që shfaqet pa ndonjë shkak të dukshëm. Ndjenjat e panikut, zakonisht zgjasin vetëm 5-10 minuta, por mund të oshilojnë për një periudhë deri në dy orë.

1.6.2. Ataku i panikut

Simptomat kryesore të këtij çrregullimi, janë shenjat e ankthit të shfaqura papritmas , dhe rritja dramatike dhe spontane e frikës për përfundim katastrofik.

Ekzistojnë tri hipoteza rreth shkaqeve të çrregullimit të panikut.

- ✓ Hipoteza e parë është “çrregullimi biokimik i trurit”
- ✓ Hipoteza e dytë “Hiperventilimi”
- ✓ Hipoteza e tretë “anormaliteti konjitiv ose njohës,

Por shumë të ngjarë, ka kombinimi i hipotezës së parë me të fundit, pra anomalitë e neurotransmetuesve me anomalitë konjitive.

Çrregullimi i panikut diagnostikohet vetëm atëherë , kur ataket e panikut janë të përsëritura, dhe të papritura, ndërkohë që i sëmuri ka frikën e vazhdueshme se mos i ndodh i ndodh një tjetër atak të pakten për një muaj. Ky çrregullim zgjat disa javë ose muaj dhe mund të bëhet kronik. Njerzit që vuajnë nga çrregullimi i panikut, zakonisht , midis atakeve shfaqin nervozizëm dhe shqetësim.

Shpesh çrregullimi i panikut pasohet nga shfaqja e agorafobisë. Takohet më tepër në femra se në meshkuj, dhe fillon në fund të adoleshencës, ose në moshën e pjekurisë hershme, por mund të fillojë , edhe më vonë në dekadën e katërt ose të pestë të jetës

1.6.3. Diagnoza e atakut të panikut

Kjo diagnoze vendoset kur ataket shfaqen papritur (jo si përgjigje ndaj një stimuli fobogjen) dhe janë të përsëritshme. Të sëmurët jetojnë vazhdimisht me ankthin e përsëritjes së këtyre krizave. Kjo është një shenjë dalluese për atakun e panikut nga çrregullimi i ankthit të përgjithshuar (gjeneralizuar).

Diagnostimi e atakut të panikut kërkon të jenë të pranishme të paktën katër prej simptomave fizike të mëposhtme të shfaqura në minutat e para të fillimit të episodit (sipas kriterëve të DSM-IV-TR):

1. -palpitacione ose rrahje të shpejta të zemrës
2. -djersitje
3. -dridhje ose shkundje (lëkundje)
4. -dispne, ndjenjë e bllokimit ose e ngadalësimit të frymëmarrjes,
5. – mungesë rehatije
6. -ndjenjë e mbytjes (si shtërngim në fyt, apo lëmsh)
7. -nauze ose shqetësim abdominal
8. -dhimbje ose shtrëngim në gjoks
9. -marrje mendsh, vertizhe,
10. - ndjenjë paqëndrueshmërie ose të fikti
11. -ndjenjë e mungesës së rehatit (derealizim), ose ndjenjë e shkëputjes nga vetja (depersonalizim)
12. -frikë mos çmendet ose bën diçka të pakontrolluar gjatë momentit të atakut
13. -frikë nga vdekja
14. -parestezi (mpirje ose ndjenjë mornicash në pjesë të ndryshme të trupit)
15. - skuqje
16. - ndjenjë të ftohti ose të nxehti në gjoks, trup, etj.

Shpesh ataku i parë i panikut shfaqet kur i sëmuri ndodhet nën ndikimin e një stresi të fuqishëm, (p.sh ndarja nga i dashuri, largim për herë të parë nga shtëpia, vdekja e një miku ose një detyrë e re, etj.). Si rregull, ataku i panikut fillon, kur të sëmurët marrin pjesë në një

aktivitet të përditshëm (p.sh psonisje ose lexim) dhe në mënyrë krejt të papritur ata ndjejnë një siklet dhe kërcënim të madh.

Disa të sëmurë e përshkruajnë këtë, sikur janë duke vdekur, ose sikur do tu ndodhë një katastrofë e madhe. Kjo ndjenjë shoqërohet me simptomat fizike të përmendura më lart. Ky atak zgjat 5-20 minuta ose rrallë deri në një orë. Ato përsëriten me një frekuencë të ndryshueshme. Ataku i panikut prek dy herë me tepër femrat se meshkujt.

Simptoma të tjera mund të përfshijnë dhimbjen e kokës, duar të ftohta, diare, pagjumësi, lodhje, futje të mendimeve dhe ruminacione.

Pacientët që vuajnë nga ataku i panikut shpesh kërkojnë ndihmën e parë te mjekët e përgjithshëm, kardiologët, dhe në mjekë të tjerë, veçanërisht kur fillimi është kryesisht me ankesa fizike (palpitacione, frikë se shqetësimi kardiak i shkakton edhe shenja të tjera somatike).

1.6.4. Pasojat e çrregullimit të panikut

Çrregullimi i panikut, mund të çojë në një kufizim të rëndësishëm në stilin e të jetuarit. Shumë njerëz me agorafobi e kanë të vështirë të udhëtojnë vetëm ose të jenë në turma ose markete ose në transport publik. Individët me çrregullim paniku mundet gjithashtu t'i bëjnë ballë problemeve me punësimin dhe depresionin.

Për më tepër, personat me çrregullim paniku kanë risk më të lartë për abuzim me alkool dhe suicidalitet sesa popullsia e përgjithshme (megjithëse disa studime sugjerojnë që çrregullimi i panikut në vetvete nuk është një faktor risku për suicidalitet në mungesë të risqeve të tjera, si çrregullimet afektive, abuzim me substanca, çrregullime të ngrënies dhe çrregullime të personalitetit.

1.6.5. Tipet e atakeve të panikut

Ataket e panikut të papritura nuk kanë sinjale apo shkaqe precipitimi; këto atake shpesh mbështesin diagnozën e çrregullimit të panikut pa agorafobi.

Ataket e panikut kanë më shumë gjasë të shfaqen në lidhje me një situatë kërcënuese, por zakonisht nuk kanë shkaqe evidente. Ky lloj çrregullimi përshkruhet si çrregullim paniku me agorafobi.

Një variant i çrregullimit të panikut i palidhur me frikën (çrregullim paniku jo fobik) ka të bëjë me një përqindje të lartë të shkaqeve mjekësore (32-41% e pacientëve me këtë çrregullim kërkojnë trajtim për dhimbje gjoksi) dhe prognozë jot ë mirë'

1.6.6. Faktorët precipitues të panikut

- Dëmtimet aksidentale (p.sh, aksidentet, ndërhyrjet kirurgjikale)
- Sëmundjet
- Humbjet dhe konfliktet interpersonalë
- Përdorimi i kanabis

- Përdorimi i stimulantëve, të tillë si kafeina, dekongestionantët, kokaina dhe simpatomimetikët (p.sh, amfetamina, MDMA)
- Sisteme të transportit publik dhe supermarketet, magazinat (veçnisht në pacientët me agorafobi)
- Sertralina, e cila mund të nxisë panic në pacientët të cilët më parë nuk kanë manifestuar simptoma paniku
- Sindromi i ndërprerjes së inhibitorëve të rikapjes së serotoninës (antidepresivëve – SSRI-të), të cilët mund të nxisin shfaqjen e simptomave të ngjashme me ato të pacientëve m atake paniku.

1.6.7. Sa frekuent është çrregullimi i panikut?

Nga studimet epidemiologjike është gjetur se çrregullimi i panikut ka një prevalencë 3.5% në popullatën e përgjithshme, femrat kanë përvoja paniku dy herë më shumë se meshkujt (5% kundrejt 2%). Shpërthimi i çrregullimit të panikut është para moshës 30 vjeç (shpesh fillon edhe në adoleshencë), megjithatë janë gjetur mjaft raste me fillim të sëmundjes në moshë më të vonë.

Fillimi i sëmundjes në moshë të vonë i sugjeron mjekut të dyshojë për ndonjë patologji të mundshme organike. Ecuria e çrregullimit të panikut është e ndryshme në individë të ndryshëm: 1/3 e pacientëve stabilizohen, 45% kanë ecuri të pandërprerë, me karakter kronik, ndërsa 24% kanë ecuri intermitente, me relapse dhe remisione.

Agorafobia mund të jetë një sëmundje me ecuri kronike, e cila mund të përsistojë pavarësisht prezencës ose jo të atakeve të panikut. Në rastet e raste të tjera, frika preekzistuese të të paturit të një ataku të mundshëm paniku mund të jetë e mjaftueshme për të vazhduar sjellja shmangëse agorafobike. Mjekimi i hershëm i çrregullimit të panikut mund të pengojë avancimin e agorafobisë.

Çrregullimi panikut pa agorafobi diagnostikohet dy herë më shumë se çrregullimi panikut me agorafobinë, në femra se në meshkuj.

Kjo ka të bëjë me shifrat e prevalencës nga 1.5-3.5%. rreth 1/3 e personave të diagnostikuar me çrregullim paniku në një kampion komunitar, do të kenë edhe agorafobi (kjo përqindje është më e lartë në kampionet e mara në mjediset klinike).

Agorafobia nënkupton frikën për të qënë vetëm, frika për t'u larguar nga shtëpia, ose frika për t'u ndodhur në sheshe publike nga të cilat largimi mund të jetë i vështirë (psh kur ka grumbullim njerëzish ose vende të mbyllura) dhe ku ndihma nuk mund të jetë e lehtë, në rastet kur personi shfaq një simptomë që mund të jetë invalidizuese ose shqetësuese.

Simptomat më tipike që hasen në këta të sëmurë janë: marrje mendsh, ose rrëzim në tokë, humbje e kontrollit të urinimit ose e ujit të trashë, të vjella, palpacione dhe dhimbje gjoksi. Kjo i bën ata të kufizojë udhëtimet, ose të kërkojnë një shoqëruar kur largohen nga shtëpia. Në frikërat më të zakonshme që ankojnë të sëmurët agorafobikë janë të qënurit vetëm larg shtëpisë, të qënurit midis turmës, lëvizja ose kalimi mbi urë dhe me mjete publike të transportit.

Shpesh agorafobia dhe ataku i panikut ndodhin së bashku, dhe mendohet se ataket e panikut shfaqen të parat dhe agorafobia është si përgjigje e këtyre episodeve tmerruese të panikut. Njerëzit që kanë atake të përsëritura të panikut, shfaqin një ankth paraprak midis atakeve dhe janë të preokupuar me frikën e manifestimit të atakeve pasuese. Numri i fobive rreth vendeve ku kanë përjetuar atake në të kaluarën rritet, (p.sh në supermarket, gjatë ngarjes me makinë). Shumë persona nuk kërkojnë ndihmën e duhur mjeksore madje një pjesë e tyre mbyllen brenda në shtëpi dhe nuk janë më në gjendje të largohen nga shtëpia, ose edhe të

qëndrojnë vetëm për një kohë të shkurtër. Agorafobia zakonisht zhvillohet kur individi ka përjetuar më parë një atak paniku ose simptoma paniku dhe ai vazhdon të manifestojë sjellje shmangëse kundrejt situatave të indukojnë panik.

1.7.Fobia specifike

Fobia specifike është një frikë që lidhet në mënyrë të dukshme me ekzistencën e një situatave apo objekti specifik.

Janë frikërat nga objektet ose situatat specifike, krejt ndryshe nga ato të qënurit vetëm, larg shtëpisë ose shqetësimit publik. P.sh frika nga insektet, infeksionet, kafshët, gjarpëri, frika nga lartësitë, nga sëmundjet, vendet e mbyllura, lartësitë (urat) etj.

Në shumicën e njerëzve me fobi, ankthi shfaqet jo vetëm, kur ata përballen me ngacmuesin e frikshëm, por edhe kur presin të takohen me të.

1.7.1. Fobitë shoqërore

Nënkuptojnë frikërat nga vënia në siklet ose poshtërimi në situata ku individi duhet të bashkëpunojë me njerëzit, p.sh. frika nga fjalimet publike, nga përdorimi i tualeteve publike ose ngrënia përpara publikut. Në këto situata ata kanë frikë dhe përjetojnë ankth i cili shoqërohet me një varg simptomash fiziologjike si tremor, palpitacione, djersitje dhe rënie të fikti. Këta individë kanë shumë frikë se njerëzit e tjerë do të zbulojnë shqetësimin e tyre dhe se ata do ti tallin, ndjenjë kjo që i çon ata në izolim shoqëror. Prek moshat në vitet e fundit të rinisë ose në vitet e para të të njëzetave, por mund të prek si adultët ashtu edhe fëmijët.

Ekspozimi ndaj stimujve fobik shkakton një shqetësim të shprehur, i cili mund të jetë i ngjashëm me një atak paniku.

Frikërat janë të zakonshme në popullatën e përgjithshme, por kur kjo frikë shkakton dëmtim deh distress të shprehur, atëherë është e mjaftueshme për të diagnostikuar fobinë specifike. Në popullatën e përgjithshme, prevalenca e fobive vlerësohet të jetë 10-11.3%. Moshë e fillimit është zakonisht e ndryshme, në varësi të llojit të fobisë specifike.

Fobitë situacionale kanë një tip dy modelësh, me një pik fillimi në fëmijëri dhe pikë dytë në mes të njëzetave.

1.8. Çrregullimi obsesiv-kompulsiv (OCD)

OCD karakterizohet nga obsesione dhe/ose kompulsione, mjaftueshmërisht të shprehura për të konsumuar kohën e pacientit, për të patur një performancë të mirë, atij i duhet të konsumojë më shumë se një orë në ditë duke shkaktuar distress të dukshëm ose dëmtim domethënës (sinjifikativ). Në një moment të caktuar, individi i njeh dhe i pranon obsesionet/kompulsionet si mjaft të rënda, jo racionale dhe ndjehet i pafuqishëm për t'i mposhtur ato.

Obsesionet përkufizohen nga DSM-IV si:

- Mendime, imazhe, impulse persistente dhe rekurente, të cilat janë të papërshtatshme dhe që shkaktojnë ankth ose distress të dukshëm
- Mendime, imazhe, impulse të cilat nuk janë thjesht si shqetësime të ekzagjeruara rreth problemeve reale të jetës
- Një përpjekje prej individit për të injoruar ose shtypur të tilla mendime, imazhe dhe impulse, ose i neutralizojnë ato në mendime dhe veprime të tjera
- Njohje të faktit se këto mendime, imazhe dhe impulse obsesive janë produkt i një mendjeje “të sëmurë” (dhe nuk vijnë nga jashtë, si një inserim mendimi si në skizofreni).

Kompulsionet përkufizohen nga DSM-IV si:

- Sjellje përsëritëse (p.sh, larje e duarve, renditje dhe verifikime), ose aktivitete mendore

(p.sh, numërimi dhe përsëritje e fjalëve përsëritëse më zë të ulët), të cilat personit i marrin shumë energji dhe kohë për të performuar në përgjigje të këtyre obsesioneve ose të aplikojnë rregulla strikte

- Sjellje ose veprime mendore të krijuara për të parandaluar ose pakësuar shqetësimin.

Ndërkohë që edhe sjelljet përsëritëse (ritualet) kanë tendencë që të shkaktojnë ankth, qetësimi mund të jetë i përkohshëm dhe këto veprime përsëriten shumë herë me qëllimin për të pakësuar ankthin.

Ritualet shpesh fillojnë ta humbasin rolin dhe fuqinë e tyre si qetësues të ankthit që shkaktohen nga obsesionet dhe kompulsionet, kështu që njerëzit zhvillojnë rituale komplekse në rritje, ose i marrin atyre shumë kohë për të performuar në mënyrë perfekte. OCD mundet gjithashtu të çojë në situata dhe objekte shmangëse, p.sh, frika për të qëndruar në shtëpi për shkak të tundimit, shtytjes për të numëruar qimet e maces.

OCD është një prej pak çrregullimeve frekvente të ankthit që ka një prevalencë rreth 2.5%. kjo prevalencë është e barabartë në të dy gjinitë.

OCD mund të shfaqet në çdo moshë, por më e shpeshtë është në adoleshencë dhe në adultërinë e hershme. Në moshat e hershme fillimi i këtij çrregullimi ndodh më shumë tek meshkujt se femrat, gjysma e atyre me OCD fillon para moshës 15. Fillimi i simptomave është gradual, me fluktuacion të gravitetit për gjatë ecures së viteve. Simptomat janë më të shprehura dhe ekzacerbohen nga stresi. Për shkak se, në fillim individët me OCD i fshehin simptomat e tyre, madje shumë prej tyre nuk kërkojnë ndihmë deri në 10 vjet pas fillimit të sëmundjes.

Simptomat janë prezantuar si kategori të tilla: kontrollimi, verifikimi, larja, numërimi dhe nevoja për të bërë ritual simetrike, mendime obsesionale. Verifikimi dhe larja rituale e duarve janë ndër manifestimet më të zakonshme të OCD.

Mendimet obsesionale më tipikisht janë agresive, seksuale dhe fetare, etj.

Simptomat multiple janë më të zakonshme. Nëpërmjet një trajtimi optimal, afërsisht 90% e personave me OCD mund të pritet një përmirësim i moderuar i simptomave të këtij çrregullimi. Shërimi i plotë ndodh shumë rrallë.

1.9 .Çrregullimi i ankthit të përgjithësuar

Çrregullimi i ankthit të përgjithësuar është gjithashtu një tjerër lloj çrregullimi ankthi, që haset shpesh në praktikën e përditshme mjekësore, madje shumë më shpesh në mjediset e shërbimit primar se në ato psikiatrike.

Simptomat e këtij çrregullimi janë:

- parehati fizike, ndjenjë e të qenit i shqetësuar, i turbullt
- lodhje
- vështirësi në përqëndrim, ose ndjesi e të qenurit pa mendime, “kokën bosh”
- iritabilitet
- tension muskular
- prishje të gjumit

Diagnoza vendoset kur janë të pranishme të paktën tre nga simptomat e mësipërme.

Prevalenca në popullatën e përgjithshme është 5.1% me prevalencë më të lartë te femrat 6.6% kundrejt 3.6% në meshkuj.

Paraqitja e një personi me çrregullimin e ankthit të përgjithësuar është mjaft karakteristike. Mimika duket e habitshme, me rrudha në ballë; qëndrim i tensionuar, shqetësim dhe të dridhura. Mund të shihen lotë, të cilët na bëjnë të keqvlërësojmë gjendjen duke e diagnostikuar me depresion.

Pacienti duke qenë i pavëmendshëm ankon për dobësim të kujtesës, por në të vërtetë, ky çrregullim nuk dëmton kujtesën, por duhet ditur se, në rastet kur dëmtimi i kujtesës persiston atëherë duhet dyshuar për praninë e ndonjë çrregullimi organik.

1.9.1 Cilat sëmundje psikiatrike mund të shfaqin çrregullimin e ankthit të përgjithësuar?

Rreth 50-90% e pacientëve me çrregullimin e ankthit të përgjithësuar kanë komorbiditete psikiatrike.

Ndër komorbiditetet psikiatrike më frekvente janë sëmundjet e humorit, depresioni madhor dhe distimia janë dy sëmundje që takohen shpesh me çrregullimin e ankthit të përgjithësuar. Çrregullime të tjera të ankthit janë gjithashtu komorbiditete të mundshme, çrregullimi i panikut, fobia e thjeshtë, fobia sociale dhe çrregullimi obsesiv-kompulsiv.

Diagnoza diferenciale

Çrregullimit të ankthit të përgjithësuar duhet diferencuar me:

- depresionin
- fobinë specifike
- fobinë sociale
- PTSD
- çrregullimin e panikut
- anoreksinë dhe buliminë
- çrregullimin e somatizuar
- çrregullimin e personalitetit, varës, shmangës
- abuzimin me substanca (nikotinën dhe kafeinën).

Simptomat e zakonshme që lidhen me çrregullimin e panikut mund të përfshijnë:

- humori depresiv
- të qara, ndjenjën e mungesës së shpresës
- ankth dhe shqetësim
- të qenit i paaftë për të përballuar jetën
- pagjumësi
- simptoma fizike, si dhimbje koke, gjoksi dhe palpitacione
- interference me rutinën e përditshme
- sjellje agresive dhe antisociale (më e zakonshme në adoleshentët)
- sjellje regresive (më të shpeshta ndër fëmijë)

1.10. Vlerësimi i riskut për suicid dhe i veprimeve vetdëmtuese.:

- çështje të punsimit, familjare
- suporti familjar
- personaliteti
- përdorimi i substancave (alkool, drogë)
- çështje financiare
- çështje kulture, etj

110.1. Vlerësimi i ashpërsisë

Nuk gjendet ndonjë shkallë matëse e standartizuar për ashpërsinë e simptomave të ankthit, e vlefshme për tu përdorur në shërbimet e kujdesit primar. Megjithatë një përdorim të gjerë, kanë instrumentat matës vetraportues për vlerësimin e distresit subjektiv të personave me ankth. Gjithashtu shkallet vetëmonitoruese masin frekuencën, dhe zgjatjen e simptomave

të panikut,dhe të simptomave të ngjashme me të, si edhe vlerësojnë situatat në të cilën ato shfaqen.Këto instrumenta vlerësojnë edhe shkallen e dëmtimit që pëson individi si pasojë e ankthit,dhe të masin edhe rezultatet e trajtimit të përdorur.

1.11. Diagnoza diferenciale e ankthit me sëmundje të tjera

Kur vlerësohet një pacient me çrregullimet e ankthit është e rëndësishme të dyshohet për çrregullime që kanë të bëjnë me përdorimin e substancave.Simptomat e ankthit mund të jenë si efekt të drejtpërdrejtë fiziologjik të substancave ose si simptoma bashkëshoqëruese të çrregullimit të ankthit me çrregullimet e shkaktuara nga substance.

Diagnoza diferenciale e simptomave të ankthit bëhet kur:

- kemi të dhëna për marrje të tepruara të alkoolit ose marihuanës
- modeli i përdorimit të substancës bëhet si nevojë për të” kuruar “, lehtësuar ankthin
- referohet histori për abuzim me anksiolitikë ose barbiturate
- referohet një anamnezë familjare dhe personale me problem për abuzim me alkoolin apo substanca të tjera
- trajtimi për gjendjet e ankthit nuk përdoret rregullisht,pra ka të dhëna për kompijancë të dobët
- merren rezultate të dobëta prej trajtimit për ankth e depresion

1.12.Çrregullimi stresit të pas traumës (PTSD)

E ardhmja e rëndësishme e PTSD është zhvillimi i simptomave psikologjike direct apo

Indirekt,pas një ekspozimi,ndaj një stresi të madh,jo normal i eksperiencave njerzore.Simptomat mund të duken shumë shpejt,pas një ngjarje si abuzimet seksuale,aksidentet automobilistike,plaçkitjet,por shenjat mund të jenë të përjashtuara,kështu që ato mund të shfaqen për disa muaj me radhë.

Kur PTSD diagnostikohet ,pacienti duhet të ketë qenë i ekspozuar,ndaj një ngjarje traumatike në të cilën ai ishte prezent.Pacienti mund të jetë përballur me të me nje ngjarje që mund të ketë ndodhur tani ku realisht ai ndihet kërcënuar për vdekje,apo me dëmtime serioze të integritetit fizik si të vetë atij,apo edhe të të tjerëve.

- Përgjigjia e tyre përfshin frikën e madhe të dobsisë deri ne llahtarisje.

-Njarjet traumatike janë vazhdimisht të përsëritua në një ose shumë mënyra.

- Vështërsi periodike,angështim dhe e pamundur për të kujtuar ngjarjet.

- Vështërsi periodike për të ëndërruar pë një ngjarje të caktuar

-Ndjenja se ngjarjet ishin periodike më përfshirje të deluzioneve dhe haluçinacioneve dhe veçimin e episodve të ikjes nga problemi.

- Përqëndrimi i ankthit psikologjik, pranë ekspozimit të brendshëm apo të jashtëm të frikës, i cili simbolizon apo ngjason me aspektin e ngjarjes.

- Reagimi psikologjik(i brendshëm,ose jashtëm) i ekspozimit të frikës,ngjasojnë me aspektin e nje ngjarje traumatike.Përsoni vazhdimisht shmang stimujt e shoqëruara me tronditje,dhe kundërpërgjigjet e tyre emocionale mund të jenë të ngrira dhe të ngathta.Kjo i indikohet nëpërmjet ndjekjes dhe përpykjes,për të shmang ,mendimet,ndjenjat,ose edhe bisedat të cilat flasin për trauma.

. - Shmangia e situatave në të cilat kemi stimulim të memorjes nga traumat.

-Paaftësia për të tërheqë aspektet e rëndësishme të një traume .

-Ulja në mënyrë të dukshme e pjesmarrjes në aktivitete të ndryshme

-Të ndjerit i pambrojtur dhe i huaj me të tjeret.

-Kufizimi në masë i efekteve si paaftësia për tu ndier i dashuruar dhe për të dashur të tjeret në përgjithsi.

-Ndjesia e një të ardhme të shkurtur ,pamundësi për tu rritur në karriere ,pamundësi për tu martuar , dhe pamundësia për të pasë një jetë normale.

Përsoni gjithashtu ka të ngjarë të paraqesë,simptomat e vazhdueshme të reagimit psikologjik,të cilat mund të përfshijnë :-1- vështërsi apo pamundësi për të fjetë,

-2-irritim dhe vështërsi për tu përqënruar,

-3-hipervigjilencë dhe përgjigje të tepruara.

Bazuar në të gjitha masat e marra nga komuniteti i njerzve me prevalence të PTSD tregon një rritje prej 1-4%.Këto shifra përputhen plotësisht , me metodat e studimit dhe të testimin të njerzve . Megjithse mes këtyre njerzve , të cilët kanë qenë të ekspozuar ndaj një trauma psikologjike si:viktima të dhunës dhe të kimit,dhe të shprënguljes në masë, prevalenca në këto raste tregon një rritje më të madhe si nga 3-58%.Këto shifra tregojnë se PTSD është një problem madhor i shëndetit mendor në disa grupe.

Egziston mundësia që çrregullimi i PTSD të jetë shfaqur që në fëmijëri ,megjithatë shenjat mund të jenë mesatare, njerzit mund të bëhen lehtësisht të irrituar ose mund të shfaqin lehtësisht shenja zëmrimi. Ngjarjet e zakonshme tregojnë për trauma të cilat mund të nxiten si pasojë e stimulimit nga një imazh nxitës.

Zgjatja e ekspozimit ndaj një ngjarje traumatike janë faktorë shumë të rëndësishem, në mundësinë e zhvillimit të një ngjarje traumatike.Nëse stresi është mjaft i fortë një person mund të zhvillojë PTSD por pa pasur një të ardhme që i paraprin ankthit të tyre.Nëse stresi është i tejzgjatur ,dhe ndodh në moshat e hershme,kjo mund të ketë efekte të zgjatura në emoozionet e fëmijërisë,si në zhvillimin e njohjes ashtu edhe në aspektin social(99)

Simptomat e PTSD zakonisht fillojnë brenda tre muajve të parë të shfaqjes së traumës. Ecuria e sëmundjes është e ndryshme që do të thotë se disa përmirsohen brenda 6 muajve të parë ,ndërsa disa të tjerë simptomat mund të zgjasin edhe më gjatë.Në disa raste sëmundja mund të zhvillohet plotësisht për disa vjet.Megjithse përsoni do të përshkruaj disa simptoma të veçanta të PTSD,si p.sh frika për situata të caktuara në të cilat trauma apo tronditjet mund të shfaqen në çdo moment.

Njerzit me PTSD do të jenë përherë të ndikuar nga një qëllim personal, të cilin ata gjithnjë ja atribuojne aspektit të një traume.(si p.sh ndonjëri mund të ketë vuajtur në fëmijëri nga abuzime të ndryshme, të tillë ata bëhen fajtorë me veten e tyre dhe në këto raste ata ndjehen fajtorë dhe përgjegjës, duke besuar se ata nuk janë përsona të vlefshëm, dhe si të tillë nuk janë të lumtur me veten e tyre ,dhe bëhen gjithmonë të mërzitshëm me përsonat e tjerë.Mes simptomave të dukshme ata mund të kenë edhe simptoma të tjera si :-dëmtim të vetvlerësimit,- paraqesin varfëri në të funksionuarit social,- vështërsi në krijimin dhe mbajtjen e e mardhënieve ndërpersonale,- dhe ajo qe është shumë domethënëse është risku i lartë për suicid(vetvrasje.)(96)

1.13 .Çrregullimi stresit akut

Stressi akut vepron si një çrregullim transit, i cili zhvillohet në përgjigje të ngjarjeve traumatike.E ardhmja e rëndësishme e PTSD pranohet se në këtë aspekt shenjat mund të shfaqen zakonisht 4 javë pas tronditjes ose traumës së ndodhur maksimumi në 4 javët e fundit.Personi vuan nga një çrregullim i stressit, me dëmtim të funksionimit në përgjithsi, dhe kjo zakonisht siguron diagnozën e saktë.E përbashkta e këtyre individëve me këto lloj eksperiencash është shfaqja e shenjave për ditë dhe javë pas një ngjarje traumatike.Duke përshkruar edhe ndjekjen e simptomave të pacientëve , mund të ndihmojnë në paksimin e ndjenjës së izolimit dhe të ankthit të shumtë.Raportimi i veprimeve të reagimit mund të

përshijnë:-ankthi ose frika e të qenit vetëm në situatë të rrezikshme dhe të frikshme,të cilat ndihmojnë që të paraqesin frikën se ,ngjarje të tilla mund të ndodhin përsëri.

- -Shmangia e situatave dhe e mendimeve të cilat të kujtojnë ngjarjet traumatike.
- -Rikthim i menjëhershëm te imazhet e ngjarjeve traumatike që vijnë papritur në mendjen e tij
- -Simptoma fizike si dridhje muskulare të shoqëruara me lodhje
- -Humbje e interesit nga aktivitetet e zakonshme përfshirë humbjen e oreksit dhe interesit seksual.
- -Pikëllim ose ndjenja e humbjes dhe e vetmisë.
- -Të ndjerit i shokuar ose mosbesimi se gjithçka mund të ndodhi, dhe ndjesia e mpirjes, të ndierit jo i vërtetë ,i izoluar dhe i pambrojtur.
- -Probleme të shumta me gjumin(pamundësi për të fjetë).
- -Probleme me përqëndrimin e vëmëndjes
- Preokupim i tepërt për traumat
- Fajtor dhe vetdyshues për veprimet dhe fatin që mund të pësojë si pasojë e një traume, ose ndjesia e të qenit më i hapur me të tjeret.
- Gjithnjë i mërzhitur dhe duke pyetur veten : “ **O zot pse mua**”

JO çdo kush ka përvojën e reagimit, dhe këta persona duhet të fshijnë nga mendja e tyre ndodhitë e javës.Nëse personi vazhdon me këtë përvojë të tij në lidhje me ngjarjet tronditëse pas një muaji, atëhere kemi të bëjmë për një diagnozë të mundshme të PTSD.

1.14. Çrregullimi përshtatjes

Çrregullimi i përshtatjes manifestohet me depresion ose ankth, dhe karakterizohet nga një periudhë e shukrtur e paqëndrueshmërisë emocionale dhe shqetësime në sjellje, në përgjigje të ndryshimeve të rëndësishme të stresit në jetë.Çrregullimi i përshtatjes vetëm sa është diagnostikuar, por sidoqoftë nëse personi vazhdon të ketë disstres me tepri të madhe gjithmonë brenda nivelit të pritshëm për të dhënë një shkaktarë, si e tillë jep dëmtime të rëndësishme në funksionimin social, dhe personi e ka mjaft të vështirë të zerë një punë.

Për të vënë diagnozën mjafton që simptomat të jenë të pranishme dhe diagnoza mund të vendoset brenda 6 muajve (megjithse simptomat mund të vazhdojnë nëse ato janë një pëgjigje ndaj një stresuesi kronik.

Nëse simptomat vazhdojnë është e konsiderueshme, dhënia e një alternative për diagnozën duke përfshirë edhe të përbashkta ndërmjet depresionit,GAD dhe çrregullimeve të panikut.

Është mëse e kuptueshme se stresuesit tipik janë ngjarjet jetësore duke përfshirë:

-vështërsi në bërjen e biznesit,rihyrje në jetën e përditshme si pasojë e daljes nga burgu, apo edhe pas një qëndrimi të gjatë në spital,dhe kthimit të mundshëm në shtëpi,pas një periudhe të gjatë mungese,por mund të kemi edhe ndryshime në ciklin jetësor të familjes si (martesa, lindja e fëmijve ,shkolla e fëmijve, apo edhe mundësia për tu larguar).

Brenga një lidhjeje me vdekjet apo edhe faji për një dashuri të humbur nuk janë diagnostikuar si çrregullime të përshtatjes, po të mos kishte gabime dhe dobsi në çdo kohë të cilat mund të shkaktohen nga dëmtimet e rëndësishme të funksionimit social dhe në mundësinë e zënies me punë.

1.15. Vlerësimi i variablave psikologjik

Nëpërmjet vlerësimit të simptomave të ankthit do të mund të identifikojmë faktorët psikologjikë të cilët mund të kenë precipituar simptomat ose të përjetohen si atak paniku, apo mund të kontribuojnë në trajtimin e tyre.

Duhet marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- situata familjare
- abuzimi me substanca
- abuzimi seksual
- çështje të homoseksualitetit
- aspektet kulturore
- pënësimi dhe çështjet e përgjithshme financiare

1.16. Vlerësimi i çështjeve kulturore

Individë të kulturave të ndryshme mund të shpjegojnë eksperiencat e tyre në mënyra të ndryshme. Shumë profesionistë të shëndetit mund të vlerësojnë perspektivat individuale kulturore po aq sa edhe marëdhënien terapeutike.

1.4.1 Diagnoza Diferenciale e çrregullimeve të ankthit

1. hipertiroidizmi ose hipotiroidizmi
2. hypoglicemia
3. diabeti mellitus
4. feokromocitoma
5. astma dhe sëmundja obstruktive pulmonare kronike
6. embolia pulmonare
7. çrregullimet konvulsive
8. tumoret e trurit
9. epilepsia
10. dëmtimet trunore traumatike
11. aritmitë kardiake dhe prolapsi i valvulës mitrale
12. intoksikacioni nga substancat dhe abstenenca (ndërprerja) e tyre.

1.4.2. Diagnoza diferenciale me sëmundjet psikiatrike

- depresionin
- fobinë specifike
- fobinë sociale
- PTSD
- çrregullimin e panikut
- anoreksinë dhe buliminë
- çrregullimin e somatizuar
- çrregullimin e personalitetit, varës, shmangës
- abuzimin me substanca (nikotinën dhe kafeinën).

1.4.3. Cilat janë sëmundjet mjekësore që mund të shkaktojnë ankth?

1. hipertiroidizmi ose hipotiroidizmi
2. hypoglicemia
3. diabeti mellitus
4. feokromocitoma
5. astma dhe sëmundja obstruktive pulmonare kronike
6. embolia pulmonare
7. çrregullimet konvulsive
8. tumoret e trurit
9. epilepsia

10. dëmtimet trunore traumatike
11. aritmitë kardiake dhe prolapsi i valvulës mitrale
12. intoksikacioni nga substancat dhe abstinenca (ndërprerja) e tyre.

1.4.4. Vlerësimi i ashpërsisë së ankthit

Nuk janë përdorur instrumenta vlerësues të standartizuara për vlerësimin e ankthit në sistemet e kujdesit primar. Megjithatë, mund të indikohet përdorimi i shkallëve vetëvlerësuese në një person që paraqet një distres subjektiv.

Shkallët vetë monitoruese gjithashtu masin frekuencën dhe zgjatjen e simptomave të tilla si paniku dhe situata në të cilën ai shfaqet. Ata tregojnë shkallën e dëmtimit që individit që po përjeton dhe të krijojë insight-in e duhur për situatat që kërcënojnë lindjen e ankthit. Këta instrumenta matës mund të jenë të përdorshme edhe për të matur rezultatet e trajtimit.

1.6.8. Përmbledhja e procesit të vlerësimit, dhe trajtimi fillestar

Çrregullimi i panikut me /pa agorafobi, fobia specifike, fobia sociale, çrregullimi i ankthit të gjeneralizuar, reaksioni i stersit akut, çrregullimi obsesivo – kompulsiv, çrregullimi stersit akut dhe çrregullimi përshtatjes që:

= Përcaktohet:

- zgjatja e simptomave
- ashpërsia e dëmtimit
- shkalla e shmangies fobike
- graviteti i ritualeve

Nëse nuk konstatohet shmangie e rëndësishme, atëherë fillohet e psiko-edukim , dhe nevojitet të merret në konsideratë ,zgjidhja e problemit, menaxhimi i stersit ,dhe përdorimi i teknikave relaksuese. Kur nuk ka përmirësim për 4-8 javë, kërkohet vlerësimi i gjendjes nga specialisti.

Nëse konstatohet ashpërsi e shmangies dhe dëmtimi i rëndësishëm i funksionimit, atëherë i referohet tek specialist. Kjo referencë përfshin:

- Sigurinë (për vetën dhe të tjerët)
- Çështje kulture
- Nevojë për support social
- Referim të përshtatshëm , në strukturat e sistemit të shëndetit mendor.

1.6.9. Gjetja e ndryshimeve të përshtatshme të stilit të jetës

Është me rëndësi të gjenden shkaqet e stersit, në jetën e një personi për të kërkuar mënyrat e duhura të ndërhyrjes dhe të menaxhimit të ankthit. Strukturimi i zgjidhjes së problemit, mund të jetë i dobishëm. Ndryshimi i stilit të jetës mund të:

- ✓ Reduktojë riskun e shfaqjes së çrregullimit të ankthit.
- ✓ Lehtësojë simptomat e ankthit.
- ✓ Reduktojë riskun e rëndimit të çrregullimit të ankthit, ose në rastin e çrregullimit të panikut kur ka risk të shfaqet agorafobia.

Ndryshimet e stilit të jetës, mund të ndihmojnë individin ,të përballet me stersin nëpërmjet:

- ✓ Reduktimi i stersit,- megjithatë njerzit mund të kundërshtojnë ndryshime të mëdha, në stilin e jetës së tyre, përderisa nuk është zbuluar saktësisht , shkaku i precipitimit të simptomave të ankthit.
- ✓ Reduktimit të përdorimit të alkoolit dhe barnave, përfshirë edhe psikostimuluesit të tilla si kafeina dhe nikotina.
- ✓ Krijimit të një mënyre të shëndetshme të të ngrënit.
- ✓ Ushtrime të rregullta fizike, të cilat “rrisin” qarkullimin e adrenalines në sistemin nervor, për shkak të përgjigjes “ godit dhe vrapo”.

- ✓ Relaksimit të rregullt, duke përfshirë përfshirjen diafragmatike dhe relaksimin progresiv.
- ✓ Ndhimesa praktike si p.sh kujdes për fëmijët, ndihmë buxhetore, banesë.
- ✓ Pjesmarrje në aktivitete në të cilat sukcesi është më i mundshëm.
- ✓ Përmirësime të njohura të mbartura të personit.

Të mësuarit e teknikave relaksuese

Teknikat relaksuese pakësojnë nivelet e përgjithshme të ngacmueshmërisë së sistemit autonom në individët të cilët vuajnë nga ankthi. Ata mund ta përshkruajnë veten si mjaft të shqetësuar dhe të përfshirë, kur janë në panik, ose kur ekspozohen ndaj një situatë të frikshme.

Relaksimi i rregullt mund të reduktojë ankthin, përmirsojnë gjumin, lehtësojnë edhe simptomat e tjera të stresit. Këto teknika mund të krijojnë motivimin për vazhdimin e trajtimit përderisa këto teknika relaksuese japin efekt pozitiv.

Në teknikat relaksuese përfshihen:

Reaksimi progresiv, teknikat vizuale, dhe të frymarrjes, të cilat ndikojnë mjaft mirë në relaksimin e simptomave të ankthit. Procedurat të cilat përdorin imazherinë vizuale ose fokusohen mbi përmbajtjen e të menduarit, mund të ndihmojnë ankthin për të lejuar personin të kontrollojë atë çka ai mendon.

Nëse simptomat e ankthit kanë shkaktuar, dëmtim të rëndësishëm të funksionimit ditor, si p.sh ndërprerje të detyrave dhe angazhimeve ditore, për shkak të shmangies ose të sjelljes ritual janë të këshillueshme rekomandimet e mëposhtme

Javën e parë: ndiq progresin nëpërmjet telefonit, sidomos nëse përdoren medikamente, kërkohet për efekte anësore dhe komplaincën.

- *Javën pasuese:* monitorim i përjavshëm ose, në rast nevojë çdo katër netë
- Në javën e gjashtë: kur ka një përgjigje të mirë ndaj trajtimit, vazhdohet monitorimi i përmuajshëm, sidomos kur kemi të bëjmë me raste të rënda. Graviteti i simptomave të ankthit ka rëndësi të njihen mirë nga profesionistët e shëndetit mendor, me qëllim parandalimin e dëmtimit të vetës apo të tjerëve. Njerzit, përgjithsisht nuk e kanë të lehtë të flasim për ndjenjat e tyre preokupuese. Nëse dyshohet për mungesë komunikimi, atëherë kërkohet rritja e monitorimit, dhe referimi në shërbimet e shëndetit mendor. Në ato raste kur shkalla e dëmtimit prej simptomave të ankthit është e pakët, ose personi është duke u shëruar, lypset një monitorim më i pakët, jo shumë frekuent.

1.17. Përfshirja e shërbimeve të shëndetit mendor

- Kjo bëhet kur:
- Ka risk serioz për suicide.
- Ka simptoma psikotike.
- Diagnoza është e paqartë, kërkohet vlerësim i nevojave të mëtejshme.
- Personi përjeton periudha të vështira emocionale, flashback të disasociacionit.
- Personi ka akses të kufizuar të mbështetjes sociale.
- Ka bashkpunim sinjifikant me çrregullime ose probleme të tjera komplekse.
- Ka faktorë social që kontribuojnë si p.sh të rinj me ankth për shkak të preokupimit në lidhje me seksualitetin e tij, ose faktorë që ndikojnë në vlerësimin dhe procesin e trajtimit, p.sh çështje kulture, etj
- Profesionistët e kujdesit primar nuk ndjehen të aftë të bëjnë zgjidhje.
- E kërkon vetë pacienti.
- Simptomat nuk mund të dominohen nga teknikat e përdorura deri më tani.
- Pacienti është fëmij apo adoleshent.

1.18. Informacion i përgjithshëm rreth Inventarit të Beckut për Ankthin (BAI)

Inventari i Beckut për Ankthin (BAI), krijuar nga Aron T.Beck MD dhe kolegët e tij, është një inventar me 21 pyetje me zgjidhje multiple, inventar vetraportues, që mat ashpërsinë e një gjendje ankthi në adoleshentë dhe adultë. Ky pyetësor përshkruan simptomat emocionale, fiziologjike dhe konjitive të ankthit, por jo të depresionit. Gjithashtu moshë që mund të përdoret ky instrument matës është 17- 80 vjeç, por është përdorur edhe në disa studime tek moshë 12 vjeçare si edhe në moshat 80 vjeç. Secila prej simptomave të BAI është një përshkrim i thjeshtë i simptomave të ankthit , në një prej katër aspekteve të tij: (1) subjektive (p.sh “*pamundësi për tu rehatuar/relaksuar*”), (2) neurofiziologjike (p.sh “*mpirje ose ndjesi shpimi si gjilpëra në trup*”), (3) autonome(p.sh “*ndjesi të nxehti në trup*”) , (4) të lidhura me panikun(p.sh “*frikë e humbjes së kontrollit*”). Ky instrument i BAI-, mund të administrohet edhe nga paraprofesionistët, por duhet përdorur dhe interpretuar ngs vetëm prej profesionistëve me esperiencë klinike.

Administrimi, Pikëzimi, dhe Interpretimi.

Përsonat që i përgjigjen ,plotësojnë këtë pyetësor ju kërkohet të raportojnë, se cila prej pyetjeve e ka shqetësuar më shumë gjatë javës së shkuar(duke përfshirë edhe ditën e plotësimit).Secila pyetje ka katër mundësi përgjigjeje: *Aspak*, *pak*(nuk më ka shqetësuar shumë) ; *Moderuar*(më shumë aspak e këndëshme), dhe e *Rëndë*(me shqetësoi jashtzakonisht shumë).Intervistuesi shënon vlerat mëposhtme për cdo përgjigje: *Aspak* = 0; e *lehtë* = 1; *Moderuar* = 1; dhe e *Rëndë* = 3. Pikëzimi total i 21 pyetjeve varion nga 0 – 63 pikë.Nivelët e pikëzimit ndahet në: 0-7 pikë korrespondon në nivelin “ *Minimal*”; 8 – 15, korrespondojnë me nivelin “ *e lehtë*”; 16 – 25 pikë nivel “*Moderuar*” dhe 26 – 63 pikë, korrespondojnë me nivelin e “*Rëndë*”.Simptomat referuar në pyetësor, vlerësohen duke përdorur kriteret diagnostike të DSM – IV – TR, për të arritur në diagnozën specifike, si një kategori diagnostike, me qëllim gjetjen e shkaqeve të ankthit, dhe hartimin e një plani trajtimi në bazë të niveleve të ashpërsisë.

2.QËLLIMI I STUDIMIT

2.1.Qëllimi i përgjithshëm

Qëllimi i këtij studimi është të përcaktojë prevalencën e çrregullimeve të ankthit në studentët e Universitetit të Mjekësisë Tiranë.

2.2. Objektivat specifike

Objektivat specifike të këtij studimi janë:

1. Të përcaktohet prevalenca e çrregullimeve të ankthit në studentët e Universitetit të Mjekësisë Tiranë.
2. Të përcaktohet prevalenca e simptomave të atakut të panikut në 1 muaj në studentët e përfshirë në studim.
3. Të përcaktohet prevalenca e çrregullimit të ankthit të përgjithshuar (GAD) në studentët e përfshirë në studim.
4. Të përcaktohen nivelet e ankthit sipas pikëzimit të pyetësorit të Inventarit të Beck për Ankthin (BAI).
5. Të përcaktohet korrelacioni i simptomave të ankthit me përdorimin e alkoolit.
6. Të përcaktohet niveli i ankthit në studentët e pesë Fakulteteve të Universitetit të Mjekësisë Tiranë.

1- Fakulteti i Mjekësisë Përgjithshme

2- Fakulteti i Mjekësisë Dentare

3- Fakulteti i Farmacisë

4- Fakulteti Shkencave Mjekësore Teknike

5- Fakulteti i Shëndetit Publik

3. MATERIALI DHE METODA

Ky studim u realizua me miratimin e marrë nga rektorati i Universitetit të Mjekësisë dhe nga Dekanatet e Fakulteteve Përkatëse. Pjesëmarrësit kanë dhënë miratimin e tyre pasi janë informuar mbi qëllimin e studimit.

3.1.Lloji i studimit: Ky është një studim epidemiologjik i tipit transversal (kros – seksional) me dy faza.

3.2.Periudha kohore e studimit: Faza përgatitore e studimit ka filluar në shtator 2013 me përgatitjen e pyetësorëve të strukturuar, me vetë raportim, anonim dhe duke ruajtur plotësisht konfidencialitetin. Proçesi i anketimit të studentëve është bërë në dy faza duke u fokusuar në periudha të ndryshme të vitit akademik, duke përfshirë sezonin e provimeve, respektivisht muajt Tetor – Nëntor – Dhjetor 2013 dhe Mars – Prill – Maj të 2014.

3.3.Karakteristikat e kampionit të përfshirë në studim. Studimi ynë është kryer në pesë fakultetet e Universitetit të Mjekësisë së Tiranës, janë përzgjedhur studentët e vitit I, II, III-të.

3.4.Kriteret Përfshirëse:

- 1.Të gjithë studentët e tre viteve të para pavarësisht moshës kronologjike (në fazën e parë)
- 2.Të gjithë studentët e tre viteve të para të intervalit moshor 18-28 vjeç.
- 2.Të gjithë studentët e tre viteve të para pavarësisht gjinisë dhe statusit civil.
- 4.Të gjithë studentët e mësipërm pavarësisht faktit nëse janë përdorues ose jo të ndonjë substance (kafe, alkol, barna, drogëra).
- 5.Të gjithë studentët e mësipërm pavarësisht pranisë ose jo të hereditetit familjar për sëmundje të shëndetit mendor.

3.5.Kriteret Përfshirëse:

1. Studentët që refuzuan pjesëmarrjen në studim
2. Të gjithë studentët e viteve të katërt, pesë e gjashtë të Fakultetit të Mjekësisë së Përgjithëshme
3. Të gjithë studentët e viteve të katërt e të pesë të Fakulteteve të tjera
4. Të gjithë studentët e nivelit master
5. U përjashtuan në analizën statistikore studentët mbi moshën 28 vjeç.
6. Të gjithë studentët që në fazën e parë raportuan për sëmundje somatike (anemi, sëmundje endokrinologjike, etj).

Ky studim është kryer në Universitetin e Mjekësisë Tiranë, ku numri i studentëve në tri vitet e para është i lartë (3000 studentë) dhe përben numrin total të studentëve të këtij Universiteti. Pikërisht kjo listë shërbeu si kornizë e kampionit në studim.

3.6.Përzgjedhja e kampionit: Përzgjedhja e kampionit të marrë në studim u bë sipas listës së siguruar në rektorat, për të pesë fakultetet, përkatësisht studentët në Fakultetin e Mjekësisë, Fakultetin e Farmacisë, Fakultetin e Mjekësisë Dentare, Fakultetin e Shëndetit Publik dhe në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike. Seleksionimi u realizua në mënyrë të rastësishme sipas metodës së përzgjedhjes me probabilitet proporcional me madhësinë (probability proportional to size).

3.7.Proçesi i anketimit: të dhënat personale dhe socio-ekonomike, sëmundjet fizike ose psikiatrike, të vetë studentëve ose familjarëve të tyre për një periudhë 6 mujore para

fillimit të studimit, siç është dështimi në provim, vdekja e një të afërmi ose miku, ose anëtar i familjes.

Më të detajuara janë si më poshtë:

Informacioni i përgjithshëm i kërkuar në pyetësor përmban të dhënat demografike si dhe të tjera si statusi social–ekonomik; niveli arsimor i prindërve (niveli ekonomik është përcaktuar në 3 shkallë); gjendja shëndetsore e studentit (prania ose jo e ndonjë sëmundjeje somatike apo psikiatrike); mënyra e jetesës dhe përdorimi ose jo i ndonjë substance; historia familjare, pra prania ose jo e ndonjë sëmundjeje të shëndetit mendor në familje (1, 2,3).

Numri total i pyetsoreve të përgatitur sipas metodës së përzgjedhjes me “probabilitet proporcional me madhësinë ishte $n=1800$. Numri total i popullatës në studim sipas kriterëve përfshirëse dhe përjashtuese rezultoi në $n=1559$ studentë.

Vlerësimi i nivelit të ankthit u kry duke përdorur pyetësorin me vetë-raportim Inventari i Beck-ut për Ankthin (BAI).

Inventari i Beckut për Ankthin (BAI), krijuar nga Aron T. Beck është një instrument me 21 pyetje me disa alternativa me vetë raportim që mat nivelet e ankthit në adoleshentë dhe adultë. Ky pyetësor përshkruan simptomat emocionale, fiziologjike dhe konjitive, por jo të depresionit. Gjithashtu moshë që mund të përdoret ky instrument është mbi 17 vjeç por ka gjetur përdorim është në fëmijë mbi 12 vjeç. Secila prej simptomave të BAI është një përshkrim i thjeshtë i simptomave të ankthit, në një prej katër aspekteve të tij: (1) subjektive (p.sh “paaftësi për tu relaksuar”), (2) neurofiziologjike (p.sh “mpirje ose dridhje”), (3) autonome (p.sh “ndjenjë të nxehti”) , (4) të lidhura me panikun (p.sh “frikë e humbjes së kontrollit”).

3.8.Administrimi, Pikëzimi dhe Interpretimi.

Personave që plotësojnë këtë pyetësor ju kërkohet të raportojnë se cila prej situatave e ka shqetësuar më shumë gjatë javës së fundit duke përfshirë dhe ditën e plotësimit. Secila pyetje ka katër mundësi përgjigjje: *Aspak*, *Pak*, e *Moderuar* dhe e *Rëndë*. Pikëzimi bëhet si më poshtë: *Aspak* = 0; e lehtë = 1; *Moderuar* = 2; dhe e *Rëndë* = 3.

Cut-off e përdorura në studimin tonë janë si më poshtë:

Nivelet	Pikëzimi
Minimal	0-7 pikë
I lehtë	8-15 pikë
Mesatar	16-25 pikë
I rëndë	26-63 pikë

Pas përfundimit të fazës së parë të studimit tonë tek i cili nuk u respektuan ngushtësisht kriteret përjashtuese pasi qëllimi ishte të përfshiheshin sa më shumë studentë për të arritur një madhësi kampioni e cila të siguronte realizimin e objektivave të studimit. Kështu prej 1559 studentëve të fazës së parë pasi u zbatuan kriteret e përfshirjes dhe përjashtimit mbetën 1282 studentë pjesëmarrës të kampionit tonë.

Me studentët që rezultuan me prani të niveleve mesatar dhe të rëndë të ankthit u krye një bisedë individuale. Qëllimi i kësaj bisede ishte të sqaronte kuptimin e këtij niveli të gjetur, të kryente një vlerësim të gjendjes aktuale dhe të informoheshin mbi nevojën për vlerësim klinik nga psikiatri. Ata me nivele mesatare të ankthit u referuan për vlerësim psikiatrik dhe psikologjik në QKSHM të cilës i përkisnin. Paraprakisht u arrit një marrëveshje me Shërbimin e Psikiatrisë për të konsultuar ata student të cilët do të rrezultonin me nivele të larta të ankthit. Kështu u realizuan një numër i konsiderueshëm konsultash nga psikiatrit F.E,

E.S, A.B, në këtë shërbim dhe diagnozat u vendosën pas vlerësimit klinik e mbështetur në kriteret diagnostike të DSM-IV-TR.

3.9. Analiza statistikore e të dhënave.

Variablat numerike që u përdorën: mesatarja aritmetike, mediana dhe moda; madhësitë e shpërndarjes. Për variablat kategorike u llogaritën vlerat absolute dhe përqindjet përkatëse. Krahasimi i vlerave mesatare mes dy grupeve u mundësua përmes T – testit dhe testit jo parametrik Mann-Whitney. Krahasimi i variablave kategorikë u realizua duke përdorur Pearson Chi-Square dhe Testin e Fisherit. Për të gjithë treguesit u llogaritën vlerat mesatare dhe intervalet përkatëse të besimit 95%. Në të gjitha rastet u konsiderua statistikisht sinjifikative një vlerë e $p \leq 0.05$. E gjithë analiza statistikore u realizua në SPSS (Statistical Pockage for Social, Sciences) version 15.0.

4. REZULTATET DHE DISKUTIME

Sa më i mirë të jetë shëndeti psikologjik aq më mirë është mirëqenia e përgjithshme dhe aftësia për të përballuar shqetësimet dhe problemet përgjatë jetës. Shëndeti mendor ndër studentët e universitetit cilësohet po aq themelor sa dhe çështjet e shëndetit publik, për të cilat të dhënat epidemiologjike janë të nevojshme të gjenden dhe duhen adresuar si problem prioritar.

Edukimi mjekësor është ndër më stresantët dhe sfiduesit. Studentët e mjekësisë apo profesionistët e ardhshëm do të kenë një ndikim të rëndësishëm në sjelljen dhe në stilin e jetës së komunitetit, një rol thelbësorë në parandalimin e sëmundjeve dhe në ofrimin e shërbimeve shëndetësore komunitare.

Studentët e mjekësisë përballen me emocione dhe ndjesi stresante të larmishme, gjatë evoluimit të tyre prej studentit të pasigurtë tek një profesionist të ri me plot aftësi. Ky proces sjell shqetësim mendor dhe ndikim negativ në funksionimin konjitiv dhe në të mësuar.

Një studim cross-seksional në Malajzi raporton se 41.9% e studentëve të mjekësisë kanë stres psikologjik, ndërsa një studim mes studentëve të mjekësisë në Tajlandë dhe Riad i gjeti këto shifra 61.4% dhe 57%.

Studime të mëparshme kanë treguar se studentët e mjekësisë kanë nivele të larta të ankthit dhe depresionit gjatë viteve të studimit, për më tepër ankthi dhe depresioni mund të mos jenë diagnostikuar dhe trajtuar siç duhet duke shkaktuar një nivel të lartë pasojash gjatë viteve të shkollës apo jetës.

Një studim i bërë në Suedi në 2011 gjeti një prevalencë të depresionit afërsisht 12.9 në studentët e mjekësisë. Një studim tjetër krahasues mes studentëve meshkuj në universitetin e Mansourës, Egjipt dhe në King Faisal në Arabinë Saudite gjeti se ankthi dhe depresioni përbënin një problem prevalent në të dy vëndet.

Është thelbësore të kryhet depistim për problemet e shëndetit mendor në studentët e mjekësisë, mjekët e ardhshëm. Ankthi dhe depresionin konsiderohen problem të shëndetit mendor që vijnë duke u rritur në studentët e mjekësisë, veçanërisht ndërmjet femrave. Përsa i takon shëndetit të studentëve 88% ishin të shëndetshëm ndërsa 12% kishin probleme shëndetësore.

4.A.Të dhënat demografike të popullatës në studim në periudhën Tetor – Nëntor – Dhjetor 2013

Rezulton se numri më i madh i subjekteve i përket moshës nga 18-21 vjeç. Pra moshë minimale 18 vjeç dhe moshë më e madhe e studentëve të studimit 28 vjeç, variabël i përfshirë në gjetjen e çrregullimeve të ankthit në këtë grupmoshë (tabela 1)

Tabela.4. 1/A. Shpërndarja e popullatës në studim sipas Moshës

Moshë Vjeç	Moshë e subjekteve			
	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e Vlefshme	Përqindja Kumulative
18	128	8.2	8.2	8.2
19	532	34.1	34.1	42.3
20	500	32.1	32.1	74.4
21	258	16.5	16.5	91.0
22	51	3.3	3.3	94.2
23	28	1.8	1.8	96.0
24	10	.6	.6	96.7
25	3	.2	.2	96.9
26	3	.2	.2	97.0
27	1	.1	.1	97.1
28	6	.4	.4	97.5
29	3	.2	.2	97.7
30	3	.2	.2	97.9

31	2	.1	.1	98.0
32	1	.1	.1	98.1
33	2	.1	.1	98.2
34	2	.1	.1	98.3
36	2	.1	.1	98.5
37	5	.3	.3	98.8
38	1	.1	.1	98.8
39	2	.1	.1	99.0
40	3	.2	.2	99.2
41	1	.1	.1	99.2
42	2	.1	.1	99.4
43	1	.1	.1	99.4
44	3	.2	.2	99.6
45	3	.2	.2	99.8
47	2	.1	.1	99.9
50	1	.1	.1	100.0
Total	1559	100.0	100.0	

Në tabelat e mëposhtëme A/1 dhe A/2 vërehet qartë se shpërndarja e kampionit sipas gjinisë dominohet nga vajzat me 56.9% dhe në lidhje me vendbanimin rreth 85.3% e kampionit banojnë në qytet.

Tabela 4.A/1. Shpërndarja e popullatës në studim sipas gjinisë dhe vendbanimit

	Frekuenc	Përqindja	Përqindja e Vlefshme	Përqindja Kumulative
Meshkuj	532	34.1	34.1	34.1
Femra	1027	65.9	65.9	100.0
Total	1559	100.0	100.0	

Tabela.4. A/1.1. Shpërndarja e popullatës në studim sipas vendbanimit

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e Vlefshme	Përqindja Kumulative
Fshat	229	14.7	14.7	14.7
Qytet	1330	85.3	85.3	100.0
Total	1559	100.0	100.0	

Tabela A/2 paraqet shpërndarjen e kampionit sipas fakulteteve prej nga rezulton se përqindja më e madhe e studentëve të përfshirë në studimin tonë dominohet nga ata të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike me 48.7% dhe pasohet nga studentët e fakultetit të mjekësisë me 28.6%.

Tabela .4.A/2 Shpërndarja e kampionit sipas fakulteteve


	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e Vlefshme	Përqindja Kumulative
F. i Mjekësisë së Përgjithshme	336	21.6	21.6	21.6
F. i Mjekësisë Dentare	225	14.4	14.4	36.0
F. i Shkencave Mjekësore	760	48.7	48.7	84.7

Teknike				
F. i Shëndetit Publik	117	7.5	7.5	92.2
F. i Farmacisë	121	7.8	7.8	100.0
Total	1559	100.0	100.0	

B.Të dhënat demografike të popullatës në studim në periudhën Mars-Prill-Maj të 2014.

Sipas grafikut të mëposhtëm rezultoi se pjesmarrja e studentëve në studim ka qenë në mënyrë proporcionale me numrin e përgjithshëm të studentëve në të gjitha fakultetet përkatëse. Vërehet një pjesmarrje më e madhe nga studentët e fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike.

Grafiku 4.1. Shpërndarja e popullatës në studim sipas Fakulteteve



Në tabelën 1 paraqitet shpërndarja e popullatës në studim sipas moshës me një moshë mesatare 19.7+-1.132 e cila është moshë që përkon me përzgjedhjen që është bërë në fillim të studimit

Tabela 4.1. Shpërndarja e popullatës në studim sipas moshës

	N	Min	Max	Mesatarja		Deviacioni Standart
	Kampioni				Std. Error	
Mosha	1282	18	28	19.76	.032	1.132

Ndërsa shpërndarja e popullatës e shprehur në përqindje sipas moshës është si më poshtë: dominohet nga mosha 19 vjeç me 35.5% e ndjekur nga mosha 20 vjeç me 34.3% dhe 21 vjeç me 16.3%, etj (tabela 1.1)

Tabela 4.1.1 Përqindja e popullatës në studim sipas moshës

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
18	115	9.0	9.0	9.0
19	455	35.5	35.5	44.5
20	440	34.3	34.3	78.8
21	211	16.5	16.5	95.2
22	33	2.6	2.6	97.8


23	17	1.3	1.3	99.1
24	7	.5	.5	99.7
25	1	.1	.1	99.8
26	1	.1	.1	99.8
28	2	.2	.2	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Vërehet se numri i studentëve femra dominojnë kampionin në studim dhe përbëjnë 66.4% të tij (tabela 2).

Tabela 4.2. Shpërndarja e popullatës në studim sipas Gjinisë

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
Vlerat	Meshkuj	431	33.6	33.6	33.6
	Femra	851	66.4	66.4	100.0
	Total	1282	100.0	100.0	

Grafiku.4.2. Shpërndarja e popullatës në studim sipas Gjinisë



Nga tabela vërehet se pjesa më e madhe e subjekteve të marra në studim janë nga qyteti.

Tabela 4.3. Shpërndarja e popullatës në studim sipas vendbanimit

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
Vlerat	Fshat	166	12.9	12.9	12.9
	Qytet	1116	87.1	87.1	100.0
	Total	1282	100.0	100.0	

Të dhënat e kësaj table referojnë numri më i madh i studentëve të marrë në studim, janë viti I dhe viti II, që i përket kryesisht moshës 18 – 19 vjec.

Tabela 4.4 .Shpërndarja e subjekteve sipas vitit akademik

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
Viti I	557	43.4	43.4	43.4
Viti II	464	36.2	36.2	79.6
Viti III	261	20.4	20.4	100.0
Total	1282	100.0	100.0	



Grafiku 4.3. Shpërndarja e popullatës në studim sipas vitit akademik

Tabela e mëposhtme tregon se pjesa më e madhe e studentëve të popullatës në studim janë të pamartuar 82.0%. (tabela 4.5 dhe grafiku 4.3)


Tabela 4.5 .Shpërndarja e popullatës në studim sipas gjendjes civile

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
Vlerat	Beqar	1052	82.0	82.0	82.0
	Fejuar/lidhur	210	16.4	16.4	98.4
	Martuar	20	1.6	1.6	100.0
	Total	1282	100.0	100.0	

Grafiku 4.4.

Sic vërehet nga grafiku 4, pjesa më e madhe e prindërve të studentëve në studim kanë arsim të mesëm nëna 54.4% dhe babai 54.2% ndërsa me arsim të lartë nëna 28.5% dhe babai 32.5%. Në lidhje me arsimin tetëvjeçar dhe atë pasuniversitar shpërndarja është pothuajse e njëjtë për të dy gjinitë.

Grafiku 4.5. Shpërndarja e nivelit arsimor të prindërve për popullatën në studim




Për sa i takon nivelit ekonomik studentët tanë që kanë raportuar për të ardhura “të mesme” janë 55.0%, të ardhura të ulta 35.2% dhe të ardhura të larta 9.8% e tyre.

Rezultatet e një studimi krahasues nga Fakulteti i Mjekësisë në Egjipt dhe Instituti i Shëndetit Publik në Arabinë Saudite në 2010-2011, kishte si objektivi gjetjen e prevalencës dhe prediktorëve të ankthit e depresionit ndërmjet studentëve të fakultetit të mjekësisë. I kryer në një total studentesh femra prej 450 dhe interval moshe 18-25 vjeç me një mesatare prej 21.1+- 1.4 vjeç. Përsa i përket edukimit të baballarëve, më shumë se dy të tretat (68.9%) e tyre kishin një diplomë universitare dhe pasuniversitare. Ndërkohë 57.8% e mamave të studimit më lart kishin edukim të ngjashëm me kampionin tonë. Në lidhje me punën e babait më shumë se gjysma 55.6% kishin një profesion kundrejt rreth gjysmës së nënave 49.1% të cilat ishin shtëpiake. Ndërsa në studimin tonë rezultoi se 36% e baballarëve kishin arsim të lartë e pasuniversitar kundrejt nënave me një shifër prej 32%.

Tabela.4.6 . Shpërndarja sipas nivelit ekonomik (të ardhurat mujore familjare)

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
Të ulëta (deri në 500 mijë lekë)	451	35.2	35.2	35.2
Të mesme 501 mijë – 1 milion	705	55.0	55.0	90.2
Të larta (Mbi 1 milion lekë)	126	9.8	9.8	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Grafiku.4.6.




Nga tabela e grafiku i mëposhtëm vërehet se shumica e kampionit ose 90.4% nuk janë përdorues të duhanit kundrejt 9.6% që përdorin duhan.

Tabela 4.7 .Shpërndarja e konsumit të duhanit në popullatën në studim

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
Vlerat	Jo	1159	90.4	90.4	90.4
	Po	123	9.6	9.6	100.0
	Total	1282	100.0	100.0	

Grafiku 4.7 .Shpërndarja e konsumit të duhanit në popullatën në studim



Nga tabela shikohet se shumë pak nga studentët rreth 1.6% e tyre konsumojnë një paketë të plotë (20 cigare) brenda një dite, por shumica e studentëve kanë raportuar se konsumojnë vetëm 1-3 cigare në ditë.


Tabela 4.8 .Shpërndarja e konsumit të duhanit sipas numrit cigareve/dite në popullatën në studim

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
1	116	9.0	94.3	94.3
2	3	.2	2.4	96.7
3	1	.1	.8	97.6
10	1	.1	.8	98.4
20	2	.2	1.6	100.0
Total	123	9.6	100.0	
Mungojnë	1159	90.4		
Total	1282	100.0		

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme raportojnë se shumica e studentëve të marrë në studim pijnë kafe rreth 60.5% e tyre, ndërsa ata që nuk konsumojnë kafe janë rreth 20% më pak pra 39.5% e tyre nuk konsumojnë kafe.

Tabela 4.9. Shpërndarja e konsumit të kafesë në popullatën në studim

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
Vlerat	Jo	507	39.5	39.5	39.5
	Po	775	60.5	60.5	100.0
	Total	1282	100.0	100.0	

Grafiku 4.8.

Nga tabela e mëposhtme rezulton se afërsisht 22% e studentëve përdorin më shumë se tre kafe në ditë (tabela 4.9.1)

Tabela 4.9.1 .Shpërndarja e konsumit të sasisë së kafe/ditë në popullatën në studim


	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0	1	.1	.1	.1
1	269	21.0	34.8	34.9
2	329	25.7	42.6	77.5
3	137	10.7	17.7	95.2
4	23	1.8	3.0	98.2
5	8	.6	1.0	99.2
6	4	.3	.5	99.7
7	2	.2	.3	100.0
Total	773	60.3	100.0	
Mungojnë	509	39.7		
Total	1282	100.0		

Nga tabela 4.10. figura 4.9 e mëposhtme shikohet se studentët që janë përdorues të alkoolit janë rreth 20.6% e tyre, dhe nuk janë përdorues rreth 79.4% e studentëve të intervistuar.

Tabela 4.10. Shpërndarja e konsumit të alkoolit në popullatën në studim

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
Vlerat	Jo	1018	79.4	79.4	79.4
	Po	264	20.6	20.6	100.0
	Total	1282	100.0	100.0	

Grafiku 4.9.



Nga tabela e mëposhtme vërehet se 48.5% e studentëve konsumojnë çdo ditë sasi të pakët alkoli dhe rreth 15.5% e tyre përdorin më shumë se 250 ml alkool në ditë, ndërsa 1.1% e tyre janë të alkolizuar.

Tabela 4.11. Shpërndarja e konsumit të alkoolit në popullatën në studim

	Frekuenc a	Përqindj a	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
1	128	10.0	48.5	48.5
2	26	2.0	9.8	58.3
3	59	4.6	22.3	80.7
4	41	3.2	15.5	96.2
5	7	.5	2.7	98.9
6	3	.2	1.1	100.0
Total	264	20.6	100.0	
Mungojnë	1018	79.4		
Total	1282	100.0		

Nga tabela 4.11 vërehet se 12.9% e studentëve në studim konsumojnë pothuaj çdo ditë pije energjike.

Tabela 4.12. Shpërndarja e konsumit të pijeve energjike në popullatën në studim


	Frekuenc a	Përqindja	Përqind ja e vlefsh me	Përqindja Kumulative
Pothuajse çdo ditë	165	12.9	12.9	12.9
Ndonjëherë (2-3 herë në javë)	445	34.7	34.7	47.6
Rrallë (1-2 herë në javë)	373	29.1	29.1	76.7
Shumë rrallë ose asnjëherë (më pak se 1 herë në 2 javë ose asnjëherë)	299	23.3	23.3	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Sipas tabelës 4.12 dhe grafikut 4.10 shihet se rreth 3.9% e totalit të popullatës në studim raporton të ketë hereditet për probleme të shëndetit mendor.

Tabela 4.13. Shpërndarja hereditetit familjar për sëmundje mendore në popullatën në studim

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
Jo	1232	96.1	96.1	96.1
Po	50	3.9	3.9	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Grafiku 4.10.




Sipas tabelës 4.14 dhe grafikut 4.11 raportohet se 19.8% e totalit të popullatës në studim kanë prani të sëmundjeve të lidhura me gjendrën tiroide në anëtarët e familjes.

Tabela 4.14. Shpërndarja sëmundjeve tiroidiene në familjet e popullats në studim

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
Jo	1028	80.2	80.2	80.2
Po	254	19.8	19.8	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Grafiku 4.11.



Në tabelën 4.15 dhe grafikun 4.12 vërehet se 29.5% e tyre kanë raportuar se kanë një anëtarë me sëmundje kronike.

Tabela 4.15. Shpërndarja sëmundjeve kronike në familjet e popullats në studim


	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
Jo	904	70.5	70.5	70.5
Po	378	29.5	29.5	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Grafiku 4.12.



Prania e ndonjë sëmundjeje kronike në vetë individët e popullatës në studim rezultoi të jetë 7.2 % e tyre.

Grafiku 4.13. Shpërndarja sëmundjeve kronike në popullatën në studim



II. Analiza e rezultateve të pyetsorit (Inventari i Beck-ut për Ankthin) të përdorur sipas gjetjes së simptomave dhe nivelit të ashpërsisë së tyre.

Nga tabela e mëposhtëme shihet se simptoma e “Mpirje ose ndjesi shpimi si gjilpëra në trup” u gjet në nivel të rëndë në 0.8% në gjithë popullatën në studim ndërsa në nivel të moderuar 7.3% (tabela 4.16)

Tabela 4.16. Prania e simptomës “Mpirje/ndjesi shpimi”

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0	736	57.4	57.4	57.4
1	442	34.5	34.5	91.9
2	94	7.3	7.3	99.2
3	10	.8	.8	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Nga tabela e mëposhtëme shihet se simptoma e “Ndjesi të nxehti në trup” u gjet në nivel të rëndë në 2.2% në gjithë popullatën në studim ndërsa në nivel të moderuar 15.1% (tabela 4.17)

Tabela 4.17. Prania e simptomës “Ndjesi të nxehti në trup”

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0				
1				
2				
3				
Total				

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0	512	39.9	39.9	39.9
1	548	42.7	42.7	82.7
2	194	15.1	15.1	97.8
3	28	2.2	2.2	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Nga tabela e mëposhtëme shihet se simptoma e “*Ndjesi dridhjeje në trup*” u gjet në nivel të rëndë në 3.7% në gjithë popullatën në studim ndërsa në nivel të moderuar 16.6% (tabela 4.18)

Tabela 4.18. Prania e simptomës “*Ndjesi dridhjeje në trup*”

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0	557	43.4	43.4	43.4
1	464	36.2	36.2	79.6
2	213	16.6	16.6	96.3
3	48	3.7	3.7	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Nga tabela e mëposhtëme shihet se simptoma e “*Pamundësi për t’u rehatuar*” u gjet në nivel të rëndë në 6.2% në gjithë popullatën në studim ndërsa në nivel të moderuar 21.9% (tabela 4.19)

Tabela 4.19. Prania e simptomës “*Pamundësi për t’u rehatuar*”

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0	419	32.7	32.7	32.7
1	503	39.2	39.2	71.9
2	281	21.9	21.9	93.8
3	79	6.2	6.2	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Nga tabela e mëposhtëme shihet se simptoma e “*Frikë se mund të ndodhë më e keqja*” u gjet në nivel të rëndë në 7% në gjithë popullatën në studim ndërsa në nivel të moderuar 15.4% (tabela 4.20)

Tabela 4.20. Prania e simptomës “*Frikë se mund të ndodhë më e keqja*”

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0	544	42.4	42.4	42.4
1	450	35.1	35.1	77.5
2	198	15.4	15.4	93.0
3	90	7.0	7.0	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Nga tabela e mëposhtëme shihet se simptoma e “*Marrje mendsh/ndjenjë boshllëku në kokë*” u gjet në nivel të rëndë në 5.8% në gjithë popullatën në studim ndërsa në nivel të moderuar 17.2% (tabela 4.21)

Tabela 4.21. Prania e simptomës “Marrje mendsh/ndjenjë boshllëku në kokë”

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0	535	41.7	41.7	41.7
1	453	35.3	35.3	77.1
2	220	17.2	17.2	94.2
3	74	5.8	5.8	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Nga tabela e mëposhtëme shihet se simptoma e “*Rrahje të shpejta të zemrës*” u gjet në nivel të rëndë në 6.2% në gjithë popullatën në studim ndërsa në nivel të moderuar 17.8% (tabela 4.22)

Tabela 4.22. Prania e simptomës “Rrahje të shpejta të zemrës”

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0	456	35.6	35.6	35.6
1	518	40.4	40.4	76.0
2	228	17.8	17.8	93.8
3	80	6.2	6.2	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Nga tabela e mëposhtëme shihet se simptoma e “*Mungesë qetësie*” u gjet në nivel të rëndë në 7.3% në gjithë popullatën në studim ndërsa në nivel të moderuar 16.5% (tabela 4.23)

Tabela 4.23. Prania e simptomës “Mungesë qetësie”

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0	504	39.3	39.3	39.3
1	474	37.0	37.0	76.3
2	211	16.5	16.5	92.7
3	93	7.3	7.3	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Nga tabela e mëposhtëme shihet se simptoma e “*Ndjesi tmerri*” u gjet në nivel të rëndë në 4.4% në gjithë popullatën në studim ndërsa në nivel të moderuar 12.5% (tabela 4.24)

Tabela 4.24. Prania e simptomës “Ndjesi tmerri”

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0	757	59.0	59.0	59.0
1	308	24.0	24.0	83.1
2	160	12.5	12.5	95.6
3	57	4.4	4.4	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Nga tabela e mëposhtëme shihet se simptoma e “*Nervozizëm/irritim*” u gjet në nivel të rëndë në 8% në gjithë popullatën në studim ndërsa në nivel të moderuar 18.3% (tabela 4.25)

Tabela 4.25. Prania e simptomës “Nervozizëm/irritim”

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0	463	36.1	36.1	36.1
1	483	37.7	37.7	73.8
2	234	18.3	18.3	92.0
3	102	8.0	8.0	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Nga tabela e mëposhtëme shihet se simptoma e “Ndjesi mbytjeje/lëmsh grykë” u gjet në nivel të rëndë në 3.2% në gjithë popullatën në studim ndërsa në nivel të moderuar 8.7% (tabela 4.26)

Tabela 4.26. Prania e simptomës “Ndjesi mbytjeje/lëmsh grykë”

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0	854	66.6	66.6	66.6
1	276	21.5	21.5	88.1
2	111	8.7	8.7	96.8
3	41	3.2	3.2	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Nga tabela e mëposhtëme shihet se simptoma e “Dridhje duarsh” u gjet në nivel të rëndë në 3.4% në gjithë popullatën në studim ndërsa në nivel të moderuar 8.5% (tabela 4.27)

Tabela 4.27. Prania e simptomës “Dridhje duarsh”

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0	749	58.4	58.4	58.4
1	380	29.6	29.6	88.1
2	109	8.5	8.5	96.6
3	44	3.4	3.4	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Nga tabela e mëposhtëme shihet se simptoma e “Ndjesi korrenti në trup” u gjet në nivel të rëndë në 2.7% në gjithë popullatën në studim ndërsa në nivel të moderuar 7.7% (tabela 4.28)

Tabela 4.28. Prania e simptomës “Ndjesi korrenti në trup”

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0	821	64.0	64.0	64.0
1	327	25.5	25.5	89.5
2	99	7.7	7.7	97.3
3	35	2.7	2.7	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Nga tabela e mëposhtëme shihet se simptoma e “Frikë e humbjes kontrollit” u gjet në nivel të rëndë në 2.1% në gjithë popullatën në studim ndërsa në nivel të moderuar 8.7% (tabela 4.29)

Tabela 4.29. Prania e simptomës “Frikë e humbjes kontrollit”

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0				
1				
2				
3				
Total				

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0	821	64.0	64.0	64.0
1	322	25.1	25.1	89.2
2	112	8.7	8.7	97.9
3	27	2.1	2.1	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Nga tabela e mëposhtëme shihet se simptoma “Vështirësi në frymëmarrje” u gjet në nivel të rëndë në 3.5% në gjithë popullatën në studim ndërsa në nivel të moderuar 7.2% (tabela 4.30)

Tabela 4.30. Prania e simptomës “Vështirësi në frymëmarrje”

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0	859	67.0	67.0	67.0
1	286	22.3	22.3	89.3
2	92	7.2	7.2	96.5
3	45	3.5	3.5	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Nga tabela e mëposhtëme shihet se simptoma “Frikë se vdes” u gjet në nivel të rëndë në 2.6% në gjithë popullatën në studim ndërsa në nivel të moderuar 3.2% (tabela 4.31)

Tabela 4.31. Prania e simptomës “Frikë se vdes”

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0	1062	82.8	82.8	82.8
1	146	11.4	11.4	94.2
2	41	3.2	3.2	97.4
3	33	2.6	2.6	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Nga tabela e mëposhtëme shihet se simptoma “Ndjesi lemerie/alarmi” u gjet në nivel të rëndë në 3.3% në gjithë popullatën në studim ndërsa në nivel të moderuar 7% (tabela 4.32)

Tabela 4.32. Prania e simptomës “Ndjesi lemerie/alarmi”

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0	916	71.5	71.5	71.5
1	234	18.3	18.3	89.7
2	90	7.0	7.0	96.7
3	42	3.3	3.3	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Nga tabela e mëposhtëme shihet se simptoma “Fryrje/parehati në bark” u gjet në nivel të rëndë në 3.4% në gjithë popullatën në studim ndërsa në nivel të moderuar 10.5% (tabela 4.33)

Tabela 4.33. Prania e simptomës “Fryrje/parehati në bark”

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0	678	52.9	52.9	52.9
1	426	33.2	33.2	86.1
2	134	10.5	10.5	96.6

3	44	3.4	3.4	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Nga tabela e mëposhteme shihet se simptoma “Ndjesi të fikti” u gjet në nivel të rëndë në 2.3% në gjithë popullatën në studim ndërsa në nivel të moderuar 7.3% (tabela 4.34)

Tabela4. 34. Prania e simptomës “Ndjesi të fikti”

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0	829	64.7	64.7	64.7
1	329	25.7	25.7	90.3
2	94	7.3	7.3	97.7
3	30	2.3	2.3	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Nga tabela e mëposhteme shihet se simptoma “Skuqje në fytyrë” u gjet në nivel të rëndë në 4.2% në gjithë popullatën në studim ndërsa në nivel të moderuar 12.2% (tabela 4.35)

Tabela4. 35. Prania e simptomës “Skuqje në fytyrë”

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0	549	42.8	42.8	42.8
1	523	40.8	40.8	83.6
2	156	12.2	12.2	95.8
3	54	4.2	4.2	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

Nga tabela e mëposhteme shihet se simptoma “Djerësitje jo prej të nxehtit/vapës” u gjet në nivel të rëndë në 4.3% në gjithë popullatën në studim ndërsa në nivel të moderuar 11.2% (tabela 4.36)

Tabela 4.36. Prania e simptomës “Djersitje jo prej të nxehtit/vapës”

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
0	647	50.5	50.5	50.5
1	436	34.0	34.0	84.5
2	144	11.2	11.2	95.7
3	55	4.3	4.3	100.0
Total	1282	100.0	100.0	

II. Analiza statistikore sipas rezultateve të pyetsorit BAI

Të dhënat për analizën statistikore janë përpunuar sipas SSPS 15, nëpërmjet përdorimit të BAI-it ku janë marrë në konsideratë niveli i moderuar dhe i rëndë i ankthit si rezultate që kanë rëndësi në analizën tonë.

Në analizën tonë merret në konsideratë niveli i pikëzimit të pyetësorit të përdorur BAI prej nga rezultuan dy grupe studentësh: një grup që nuk ka simptoma ankthi (e shprehur në përqindje) dhe një grup tjetër që ka nivel të lartë ankthi, persistencë të tij për një periudhë

kohore brenda 6 muajve. Ky grupi i fundit është subjekt i vlerësimit psikiatrik dhe psikologjik për të mbërritur në përqindjen e kampionit që plotëson kriteret për çrregullim të ankthit të gjeneralizuar.

Siç edhe vihet re prej të dhënave të tabelës 36 dhe figurës 1 kemi një diferencë statistikisht të rëndësishme ndërmjet dy gjinive (ANOVA, $P < 0,001$). Gjinia e cila është më e predispozuar për të shënuar pikë më të larta në pikëzimin e ankthit (dhe si pasojë më e ekspozuar ndaj simptomave të ankthit) është gjinia femërore.

Tabela 4.37 . Diferenca gjinore analizuar me metodën ANOVA

ANOVA					
	Shuma e katrorëve	df	Katrori i mesatares	F	Vlera e P-së
Ndërmjet grupeve	7481.949	1	7481.949	81.494	0.000
Brenda grupeve	117517.100	1280	91.810		
Totali	124999.049	1281			

Figura. 4.1 Grafiku i diferencës së mesatare




